



Organization for Security and  
Co-operation In Europe  
Mission in Kosovo

---

RAPORT NGA MONITORIMI I GJYKIMIT

# TË RASTEVE TË KRIMEVE TË LUFTËS NË KOSOVË

---

KORRIK 2026

---







Organization for Security and  
Co-operation In Europe  
Mission in Kosovo

---

RAPORT NGA MONITORIMI I GJYKIMIT

# TË RASTEVE TË KRIMEVE TË LUFTËS NË KOSOVË

---

KORRIK 2026

---



# PASQYRA E PËRMBAJTJES

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	5
<b>GJETJET KRYESORE</b> .....	7
<b>REKOMANDIME</b> .....	9
<b>ANALIZË</b> .....	12
<b>1. Hyrje</b> .....	12
<b>2. Metodologjia, fushëveprimi dhe kufizimet</b> .....	13
<b>3. Korniza ligjore e zbatueshme për gjykimet për krime lufte</b> .....	15
A. Standardet ligjore të zbatueshme.....	15
B. Korniza për përcaktimin e dënimeve dhe parimi i ligjshmërisë .....	15
C. Zhvillimet lidhur me kompetencat dhe kapacitetet institucionale .....	16
<b>4. Gjetjet</b> .....	18
A. Vrojtime të përgjithshme rreth rasteve të monitoruara .....	18
B. Vonesat e zgjatura në gjykimet për krime lufte .....	19
i. Respektimi i së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm .....	19
ii. Shkaqet kryesore të vonesave të evidentuara.....	20
C. Qartësia e akuzave dhe cilësia e aktakuzës .....	26
i. Individualizimi i akuzave dhe shqyrtimi i rrethanave lehtësuese në aktakuzat për krime lufte .....	26
ii. Lloji i përgjegjësisë i përmendur në aktakuza .....	28
D. Sfidat në lidhje me provat në gjykimet e krimeve të luftës .....	29
i. Besueshmëria dhe vlera provuese e dëshmisë së dëshmitarit .....	29
ii. Dëshmia e drejtpërdrejtë, deklaratat e regjistruara më parë dhe kufizimet në sigurimin e provave nga jashtë Kosovës .....	30
E. Çështje specifike për gjykimet në mungesë .....	33
i. Standardet ligjore për gjykimet në mungesë.....	33
ii. Paqartësia në lidhje me "përpjekjet e arsyeshme" për njoftimin e të akuzuarit.....	34
iii. Vonesat dhe rezultatet e gjykimeve të mbajtura në mungesë .....	36
iv. Mbrojtja e të drejtave të viktimave .....	38
v. E drejta për mbrojtje të përshtatshme .....	38
<b>5. Përfundime</b> .....	40
<b>Shtojca A</b> .....	41

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>EULEX</b>	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>GJPN</b>	Gjykata Penale Ndërkombëtare
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KPK</b>	Kodi Penal i Kosovës
<b>KPPK</b>	Kodi i Procedurës Penale i Kosovës
<b>OAK</b>	Oda e Avokatëve të Kosovës
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë
<b>PNDCP</b>	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
<b>PS</b>	Prokuroria Speciale
<b>RSFJ</b>	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
<b>TPNJ</b>	Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet gjetjet nga monitorimi i procedurave në rastet e krimeve të luftës<sup>1</sup> para Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, monitorim ky i realizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) në periudhën 1 janar 2019 deri 31 dhjetor 2025. Raporti bazohet në angazhimin afatgjatë të OSBE-së në monitorimin e proceseve të krimeve të luftës në Kosovë, pas vlerësimeve të mëhershme të publikuara në vitin 2002,<sup>2</sup> dhe 2010,<sup>3</sup> dhe pasqyron kalimin e kompetencave nga mekanizmat ndërkombëtarë dhe hibridë drejt gjykimit nga institucionet vendore. Periudha e raportimit përkon me zhvillime të rëndësishme institucionale dhe procedurale, duke përfshirë hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatat në vitin 2019,<sup>4</sup> përmes së cilit u krijuan departamente speciale brenda Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, me kompetenca ekskluzive mbi krimet e luftës, me transferimin e një numri të konsiderueshëm lëndësh nga EULEX-i te institucionet e sapokrijuara, si dhe futjen e gjykimit në mungesë përmes ndryshimeve të njëpasnjëshme të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP).<sup>5</sup> Këto zhvillime kanë kontribuar në rritjen e numrit të aktakuzave dhe në rikthim të fokusit në adresimin e pandëshkueshmërisë për shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë.

Duke u mbështetur në monitorimin e të gjitha rasteve të krimeve të luftës të shqyrtuara para Departamentit Special gjatë periudhës së përmendur, raporti identifikon një sërë sfidash të vazhdueshme dhe të ndërlidhura. Këto përfshijnë vonesat e zgjatura në procedura, pasigurinë lidhur me interpretimin dhe zbatimin e garancive procedurale në gjykimet e zhvilluara në mungesë, vështirësitë e përsëritura në lidhje me provat, përfshirë këtu sa i takon paraqitjes së dëshmitarëve, detyrimet për zbulimin e provave, cilësinë e aktakuzave dhe vlerësimin e provave, si dhe kufizimet më të gjera institucionale që kanë të bëjnë me Prokurorinë Speciale (PS) dhe gjyqësorin. Raporti gjithashtu thekson ndikimin e ndjeshmërive politike dhe efektet e vazhdueshme të bashkëpunimit të kufizuar rajonal në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin efektiv të rasteve të krimeve të luftës.

Ndonëse OSBE-ja i vë në pah zhvillimet pozitive, përfshirë hapat e ndërmarrë nga institucionet gjyqësore me kompetenca ligjore për trajtimin e rasteve të krimeve të

---

<sup>1</sup> Për qëllimet e këtij raporti, frazat “raste të krimeve të luftës”, “gjykime për krime lufte” dhe “procedura për krime lufte” përdoren në mënyrë përshkuese për t’iu referuar rasteve të ngritura sipas *Kapitullit Gjashtëmbëdhjetë* të ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së veprës së pretenduar, përkatësisht Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Përdorimi i tyre nuk pasqyron ndonjë kualifikim nga OSBE-ja të akuzave apo të veprimeve të pretenduara të kryera nga personat e akuzuar.

<sup>2</sup> OSBE (shtator 2002), Gjykimet për Krime Luftë në Kosovë: Shqyrtim. Në dispozicion në: <https://omik.osce.org/kosovo/12549> [hapur së fundi më 12 qershor 2026]

<sup>3</sup> OSBE (maj 2010), Gjykimet për Krime Luftë në Kosovë: Vlerësim Pas Dhjetë Vjetësh, 1999–2009. Në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/2/d/68569.pdf> [hapur së fundi më 12 qershor 2026]

<sup>4</sup> Gazeta Zyrtare (18 dhjetor 2018), Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat, 2018. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302> [hapur së fundi më 12 qershor 2026]

<sup>5</sup> Gazeta Zyrtare (17 gusht 2022), Kodi Nr. 08/L-032, Kodi i Procedurës Penale. Në dispozicion në: <https://md.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/07/8750FE73-BA51-463C-BA88-31D0B8865840.pdf> [hapur së fundi më 12 qershor 2026]

luftës por dhe angazhimet e aktorëve gjyqësorë për të zbatuar standardet ndërkombëtare të gjykimit të drejtë, raporti konkludon se mangësitë strukturore dhe operacionale vazhdojnë ta minojnë efikasitetin, qëndrueshmërinë dhe perceptimin e drejtësisë së procedurave. Në veçanti, vonesat dhe pasiguria procedurale rrezikojnë të ndikojnë në të drejtat e të akuzuarve, pjesëmarrjen kuptimplotë të viktimave dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

## GJETJET KRYESORE

OSBE-ja ka monitoruar 48 raste të krimeve të luftës me gjithsej 138 të akuzuar, para Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë gjatë periudhës së raportimit. Deri më 31 dhjetor 2025, ishin përfunduar 17 raste, ndërsa 88 për qind e rasteve që kishin kaluar në gjykim rezultuan me aktgjykim dënues. Gjetjet në vijim nxjerrin në pah vështrimet kryesore procedurale dhe strukturore të identifikuara përmes monitorimit të këtyre procedurave:

- **Vërehen disa zhvillime pozitive në gjykimin e rasteve të krimeve të luftës.** Këto përfshijnë rritjen e përfshirjes së institucioneve gjyqësore të ngarkuara me ligj me kompetenca mbi procedurat para Departamentit Special, numër në rritje të rasteve të përfunduara gjatë periudhës së raportimit, si dhe shembuj të praktikës së mirë në zbatimin e garancive të gjyqimit të drejtë.
- **Shqetësim i gjithmbarshëm vazhdojnë të jenë vonesat e zgjatura.** OSBE-ja ka vërejtur vonesa të përsëritura që kanë të bëjnë me mosparaqitjen e dëshmitarëve, ndryshime në përbërjen e trupit gjykues, zbulim dhe përkthim të vonuar të provave dhe kufizime logjistike që prekin transportin e të akuzuarve të paraburgosur.
- **Cilësia dhe qartësia e aktakuzave vazhdojnë të ngjallin shqetësime në raste të caktuara.** OSBE-ja ka vërejtur mangësi në individualizimin e akuzave, veçanërisht në rastet që përfshijnë shumë të akuzuar dhe forma kolektive të përgjegjësisë, si dhe në identifikimin e rrethanave lehtësuese të njohura në kohën e ngritjes së aktakuzës.
- **Sfidat lidhur me provat vazhdojnë të ndikojnë në drejtësinë e gjyqimit.** OSBE-ja ka vërejtur mbështetje të përsëritur në deklarata të mëparshme të regjistruara, ndonëse dëshmia e drejtpërdrejtë do t'i garantonte më mirë të drejtat e mbrojtjes. Derisa deklaratat e tilla mund të jenë të pranueshme në situata të kufizuara, dëshmia e drejtpërdrejtë mbetet e preferueshme sa herë që është e mundur, veçanërisht në rastet e krimeve të luftës ku deklaratat e dëshmitarëve shpeshherë janë të rëndësishme qendrore për gjykimin.
- **Sigurimi i dëshmitarëve dhe provave nga jashtë Kosovës vazhdon të jetë pengesë serioze.** Bashkëpunimi i kufizuar rajonal, i kombinuar me shqetësimet për sigurinë e dëshmitarëve dhe përdorimin të kufizuar në praktikë të alternativave, si dëshmia përmes video-lidhjes, vazhdon të ndikojë si në ndjekje ashtu edhe në mbrojtje, si dhe ngre shqetësime lidhur me barazinë e palëve në procedurë.
- **Problemet lidhur me zbulimin e provave dhe përkthimin vazhdojnë t'i pengojnë procedurat dhe të dëmtojnë përgatitjen e mbrojtjes.** OSBE-ja

gjithashtu ka vënë re pengesa praktike që prekin të akuzuarit në paraburgim gjatë shqyrtimit të dosjeve voluminoze dhe provave në formë videosh me avokatët e tyre.

- **Procedurat e zhvilluara në mungesë vazhdojnë të ngrenë shqetësime të rëndësishme procedurale.** Këto përfshijnë pasigurinë lidhur me zbatimin e standardit të “përpyekjeve të arsyeshme”, vonesat në mbajtjen e seancave fillestare dhe çështjet e pazgjidhura lidhur me fushëveprimin e mbrojtjes efektive dhe qasjen në mjetet juridike të jashtëzakonshme.

## REKOMANDIME

Rekomandimet në vijim bazohen në monitorimin sistematik nga OSBE-ja të procedurave për krime lufte gjatë periudhës shtatëvjeçare dhe pasqyrojnë gjetjet kryesore të identifikuar në këtë raport. Ato u adresohen institucioneve që janë përgjegjëse apo që kontribuojnë në hetimin, ndjekjen penale, gjykimin dhe kornizën më të gjerë institucionale mbështetëse për rastet e krimeve të luftës në Kosovë. Ndonëse shumë prej këtyre rekomandimeve nuk janë të reja dhe, në disa raste tashmë, pasqyrohen në dokumente strategjike institucionale, zbatimi efektiv i tyre mbetet i varur nga angazhimi i qëndrueshëm institucional dhe ndarja e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare.

### Për Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë

- T'i japë përparësi dëshmisë së drejtpërdrejtë të dëshmitarëve sa herë që është e realizueshme dhe të shpreshtojë përdorimin e metodave alternative të marrjes në pyetje, si dëshmi përmes video-lidhjes, për të siguruar marrje në pyetje dhe marrje në pyetje të tërthortë efektive të dëshmitarëve.
- Të sigurojë që seancat fillestare në procedurat në mungesë mbahen brenda afateve të përcaktuara nga KPP.
- Të miratojë masa praktike, në bashkëpunim me qendrat e paraburgimit, për të siguruar që të akuzuarit në paraburgim të mund t'i shqyrtojnë në mënyrë efektive dosjet voluminoze dhe video-materialet me avokatët e tyre, përfshirë përmes aranzhimeve të përshtatshme teknike dhe masave të tjera kompensuese kur është e nevojshme, për të garantuar të drejtat e mbrojtjes dhe respektuar nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- Të sigurojë që aktgjykimet e shkallës së parë të përmbajnë vlerësim të plotë dhe të individualizuar të besueshmërisë dhe vlerës provuese të dëshmisë së dëshmitarëve, veçanërisht kur paraqiten mospërputhje, trauma, çështje të interpretimit, kur ka kaluar kohë e gjatë ose kur ka faktorë të tjerë relevantë kontekstualë, me qëllim forcimin e cilësisë, transparencës dhe mundësisë së rishikimit të arsyetimit gjyqësor në rastet e krimeve të luftës.

### Për Prokurorinë Speciale

- Të tregojë kujdes të veçantë kur mbështetet në dëshminë e dëshmitarëve për aktakuza dhe kërkesa për paraburgim, përfshirë përmes vlerësimit të relevancës, besueshmërisë dhe bazës provuese të një dëshmie të tillë në fazën më të hershme të mundshme, me qëllim shmangien e mbështetjes së tepruar në deklarata që më vonë mund të rezultojnë jo mjaftueshëm të besueshme ose provuese.

- Të sigurojë individualizimin e akuzave brenda aktakuzave, veçanërisht në rastet që përfshijnë shumë të akuzuar, në mënyrë që të pasqyrohet sjellja e pretenduar dhe shkalla e përgjegjësisë së secilit të pandehur.
- Të sigurojë që rrethanat lehtësuese identifikohen dhe trajtohen si në fazë më të hershme ashtu dhe gjatë gjithë procedurës gjyqësore.
- Të sigurojë zbulimin në kohë të materialeve inkriminuese dhe shfajësuese, përfshirë përkthimin e tyre kur kërkohet, në përputhje me nenin 239 të KPPK-së, me qëllim parandalimin e shtyrjeve të shmangshme, mundësimin e përgatitjes efektive të mbrojtjes dhe garantimin e barazisë së palëve në procedurë.

### **Për Odën e Avokatëve të Kosovës**

- Të sigurojë caktimin e avokatëve mbrojtës me përvojë të dëshmuar në raste komplekse penale dhe të krimeve të luftës, veçanërisht në procedurat e zhvilluara në mungesë.
- Të ofrojë trajnime të rregullta, të orientuara kah praktika për avokatët mbrojtës, në gjuhën shqipe dhe serbe, me fokus në procedurat në mungesë dhe strategjitë efektive të mbrojtjes.

### **Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës**

- Të miratojë masa administrative ose organizative për të siguruar vazhdimësinë në përbërjen e trupit gjykues, përfshirë mundësinë e shtyrjes së transferimit të gjyqtarit deri në përfundimin e gjykimit, aty ku mund të zbatohet, me qëllim mbrojtjen e së drejtës së të akuzuarit për gjykim brenda një kohe të arsyeshme.
- Në bashkërendim me gjykatat, të shtohen angazhimet për informimin e publikut lidhur me detyrimet dhe të drejtat e dëshmitarëve, përfshirë këtu për ndihmat financiare në dispozicion për udhëtim dhe shpenzime të ndërlidhura, me qëllim uljen e vonesave dhe përmirësimin e bashkëpunimit të dëshmitarëve.

### **Për Gjykatën Supreme**

- Të nxjerrë udhëzime lidhur me llojet e zbatueshme të përgjegjësisë për krime lufte sipas Kodit Penal të Kosovës (KPK), me qëllim rritjen e sigurisë juridike, promovimin e praktikave të qëndrueshme të ngritjes së akuzave dhe të sigurojë që përgjegjësia penale individuale të pasqyrohet në mënyrë të duhur.

- Të sqarojë, përmes udhëzimeve gjyqësore, standardin e “përpjekjeve të arsyeshme” në procedurat në mungesë, përfshirë afatet kohore dhe hapat proceduralë, me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë dhe avancimit efektiv të procedurave të tilla.
- Të sqarojë, përmes udhëzimeve gjyqësore, interpretimin dhe ndërveprimin e neneve 11, 56 dhe 303 të KPPK-së lidhur me aftësinë e avokatëve mbrojtës të caktuar nga gjykata, veçanërisht në rastet e gjykimit në mungesë, për qasje në dhe shfrytëzim të mjeteve juridike të jashtëzakonshme me qëllim forcimin e sigurisë juridike, garantimin e mbrojtjes efektive dhe mbrojtjen e të drejtave për proces të rregullt në procedura të tilla.

### **Për Ministrinë e Drejtësisë**

- T’i miratojë ndryshimet legjislative në Ligjin për Gjykatat dhe KPPK-në me të cilat parashihen gjyqtarë zëvendësues në procedurat komplekse për krime lufte, me qëllim reduktimin e ndërprerjeve të shkaktuara nga ndryshimet në përbërjen e trupit gjykues, sigurimin e vazhdimësisë dhe efikasitetit në gjykim, si dhe garantimin e sigurisë juridike dhe të drejtave për proces të rregullt.
- Të hulumtojë rrugë ligjore dhe praktike për të forcuar bashkëpunimin rajonal në rastet e krimeve të luftës;
- Si institucion që ushtron mbikëqyrje mbi Shërbimin Korrektues të Kosovës, të forcojë bashkërendimin dhe aranzhimet operative për të siguruar transportin në kohë të të akuzuarve në paraburgim në seancat gjyqësore, me qëllim reduktimin e shtyrjeve të shmangshme dhe garantimin më të mirë të së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme.

# ANALIZË

## 1. Hyrje

OSBE-ja ka monitoruar sistemin e drejtësisë në Kosovë për pajtueshmëri me standardet e të drejtave të njeriut dhe gjykimin të drejtë, me qëllim forcimin e sundimit të ligjit përmes rekomandimeve të synuara.<sup>6</sup> Në këtë kuadër, OSBE-ja ka prioritetizuar monitorimin e gjykimeve për krime lufte.

Gjykimet për krime lufte përfaqësojnë një nga format më komplekse dhe më të ndjeshme të procesit penal, duke kërkuar nga gjykatat të trajtojnë akuza serioze që burojnë nga konfliktet e armatosura, shpeshherë dekada pas ngjarjeve në fjalë. Procedura të tilla zakonisht përfshijnë numër të madh provash, dëshmitarë të cenueshëm, sfida hetimore rajonale dhe pritje të larta nga viktimat dhe shoqëria në përgjithësi. Sigurimi i llogaridhënies në këto raste është thelbësor jo vetëm për drejtësinë individuale, por edhe për sundimin e ligjit, pajtimin dhe parandalimin e pandëshkueshmërisë.

Që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë, përgjegjësia për hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës është zhvendosur gradualisht nga mekanizmat ndërkombëtarë dhe hibridë drejt institucioneve vendore. Hyrja në fuqi e Ligjit për Gjykatat në janar të vitit 2019 shënoi moment të rëndësishëm në këtë tranzicion, duke krijuar departamente speciale brenda Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit dhe duke u dhënë atyre juridiksion mbi rastet e krimeve të luftës.<sup>7</sup> Ky rikonfigurim institucional, së bashku me ndryshimet legislative që futën dhe më pas zgjeruan mundësinë e gjykimeve në mungesë sipas KPPK-së,<sup>8</sup> si dhe miratimi i strategjive prokuroriale për krimet e luftës<sup>9</sup>, ka riformësuar peizazhin ligjor dhe procedural që rregullon këto procedura.<sup>10</sup> Këto ndryshime institucionale dhe procedurale kanë përkuar gjithashtu me rritjen e dukshme të aktakuzave për krime lufte në vitet e fundit, duke e bërë të përshtatshme kohën e vlerësimit të mënyrës se si janë trajtuar rastet e krimeve të luftës pas transferimit të përgjegjësisë te Departamenti Special.

Në këtë kontekst, OSBE-ja ka vazhduar mandatin e saj për të monitoruar sistemin e drejtësisë për pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe gjykimin të drejtë. Ky raport përqendrohet në gjykimet për krime lufte të mbajtura para Departamentit Special brenda Gjykatës Themelore në Prishtinë që

---

<sup>6</sup> Sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Vendimit Nr. 305 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, të datës 1 korrik 1999 (siç është interpretuar më pas që nga viti 2008).

<sup>7</sup> Po ashtu, sipas Ligjit Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale, Prokurorisë Speciale i është caktuar kompetenca për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të krimeve të luftës. Në dispozicion në:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=84236> [hapur së fundi më 12 qershor 2026]

<sup>8</sup> Gazeta Zyrtare (17 gusht 2022), neni 303. Versioni paraprak i KPPK-së (Kodi Nr. 04/L-123, 2012) hyri në fuqi në vitin 2013 dhe mbeti në fuqi deri në shkurt 2023, kur u zëvendësua me KPPK-në aktuale (Kodi Nr. 08/L-032, 2022).

<sup>9</sup> Ministria e Drejtësisë, *Strategjia për Krimet e Luftës* (Prishtinë, 2019 dhe 2025)

<sup>10</sup> Ministria e Drejtësisë (2024), *Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale*. Në dispozicion në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/06/STRATEGY-ON-TRANSITIONAL-JUSTICE-IN-REPUBLIC-OF-KOSOVO-2024-2034.pdf> [hapur së fundi më 12 qershor 2026]

nga transferimi i përgjegjesisë nga EULEX-i në vitin 2019. Raporti ofron një analizë objektive dhe të bazuar në të dhëna të çështjeve procedurale dhe kontekstuale që lindin në këto procedura, me qëllim vlerësimin e mënyrës se si funksionon në praktikë korniza aktuale. Ai shqyrton aspektet kryesore procedurale dhe materiale të këtyre procedurave, identifikon sfidat e përsëritura të vërejtura përmes monitorimit të gjykimeve dhe vlerëson ndikimin e tyre në të drejtat e të akuzuarve, interesat e viktimave dhe administrimin e përgjithshëm të drejtësisë.

Ndonëse raporti vlerëson dhe njuh përparimin e arritur në vitet e fundit, ai gjithashtu thekson se zbatimi efektiv i kornizës për krime lufte mbetet i kufizuar nga burimet e kufizuara, ndjeshmëritë politike dhe bashkëpunimi i pamjaftueshëm ndërkombëtar dhe rajonal. Analiza dhe rekomandimet e përfshira këtu synojnë të mbështesin përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve të Kosovës dhe partnerëve ndërkombëtarë për të forcuar kapacitetin, qëndrueshmërinë dhe drejtësinë e gjyqimit të krimeve të luftës në përputhje me standardet ndërkombëtare.

## 2. Metodologjia, fushëveprimi dhe kufizimet

Mostra e rasteve të analizuar në këtë raport përfaqëson të gjitha rastet që përfshijnë akuza për krime lufte<sup>11</sup> të trajtuara para Departamentit Special pas krijimit të tij sipas Ligjit për Gjykatat që hyri në fuqi në janar të vitit 2019.<sup>12</sup> Për rrjedhojë, periudha referente është 1 janar 2019 - 31 dhjetor 2025. Për qëllime të këtij raporti, referencat ndaj gjykimeve për krime lufte janë përshtetëse dhe nuk pasqyrojnë ndonjë kualifikim nga OSBE-ja të akuzave ose veprimeve të individëve. Përkundrazi, ato i referohen rasteve të ngritura sipas *Kapitullit gjashtëmbëdhjetë* të ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së veprës së pretenduar, përkatësisht Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, nën titullin "*Krim lufte kundër popullatës civile*".<sup>13</sup>

Mostra e analizuar për qëllimet e këtij raporti përbëhet nga gjithsej 48 raste, që përfshijnë 394 seanca:

---

<sup>11</sup> OSBE është gjithashtu në dijeni të dy rasteve shtesë që janë trajtuar si konfidenciale për shkak të natyrës së ndjeshme të akuzave. Në këto raste, OSBE-ja nuk ka qenë në gjendje të monitorojë drejtpërdrejt disa seanca të ndjeshme, por ka mbetur e informuar për ecurinë e përgjithshme të procedurave.

<sup>12</sup> Gazeta Zyrtare (18 dhjetor 2018), Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat. Në dispozicion në:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302> [hapur së fundi më 12 qershor 2026]

<sup>13</sup> Gazeta Zyrtare e RSFJ-së (1 korrik 1977), Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, neni 142. Në dispozicion në: <https://www.refworld.org/legal/legislation/natlegbod/1977/en/13685> [hapur së fundi më 9 dhjetor 2025]

Mostra e rasteve të krimeve të luftës para Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë (1 janar 2019 deri 31 dhjetor 2025)	
Statusi	Numri i rasteve
Raste të përfunduara	17
Gjykime që vazhdojnë	9
Procedura paraprake <sup>14</sup>	22

Të dhënat për këtë raport janë mbledhur përmes monitorimit sistematik të proceseve të krimeve të luftës para gjykatave kompetente, bazuar në pjesëmarrjen e rregullt në seancat publike, shqyrtimin e dokumenteve gjyqësore të disponueshme publikisht dhe analizën e zhvillimeve procedurale nëpër raste. Aty ku ishte relevante, gjetjet u plotësuan me burime dytësore, përfshirë kornizat ligjore të zbatueshme dhe raportet institucionale.

Mostra fokusohet vetëm në procedurat ku një aktakuzë është ngritur para Departamentit Special<sup>15</sup> dhe nuk përfshin procedurat paraprake<sup>16</sup> ose rastet e gjykuara nga tribunale ndërkombëtare ose të ndërkombëtarizuara.<sup>17</sup>

Ndërsa analiza e përgjithshme e raportit bazohet në 48 rastet e monitoruara, vlerësimi i çështjeve që lidhen me aktakuzat kufizohet në 27 aktakuza që ishin në dispozicion të OSBE-së për shqyrtim, ndërsa 21 të tjera mbeten të klasifikuara zyrtarisht.<sup>18</sup>

Duhet theksuar se, gjatë vlerësimit të vonesave dhe shkaqeve të tyre themelore, iu kushtua vëmendje e duhur rrethanave të jashtëzakonshme të lidhura me pandeminë COVID-19 në vitet 2020 dhe 2021, të cilat nuk tregojnë për ndonjë problem sistematik. Përveç kësaj, disa aktakuza të ngritura në mungesë mbeten konfidenciale dhe ende nuk kanë avancuar në gjykim, prandaj përkatësia e të akuzuarve nuk është e disponueshme.

<sup>14</sup> Për qëllimet e këtij raporti, procedurat paraprake përfaqësojnë rastet për të cilat është ngritur aktakuzë, përfshirë rastet ku është mbajtur seanca fillestare efektive, por procedura nuk ka vazhduar më tej. Është e mundur që të jetë mbajtur seancë lidhur me paraburgimin, por deri më 31 dhjetor 2025 nuk është mbajtur asnjë seancë lidhur me meritat e çështjes.

<sup>15</sup> Përfshihen rastet e gjykuara nga EULEX-i ose nga gjykata/departamente të tjera përveç Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë (p.sh. rastet e shqyrtuara nga Gjykata Themelore në Mitrovicë ose Gjykata Themelore në Prizren).

<sup>16</sup> Të përcaktuara si raste në të cilat është nisur hetimi, por nuk është ngritur aktakuzë.

<sup>17</sup> Ky raport nuk trajton rastet që bien nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara të Kosovës ose të ndonjë institucioni tjetër ndërkombëtar.

<sup>18</sup> Njëzet e një aktakuzat e mbetura nuk kanë mundur të vlerësohen për këtë qëllim për shkak të kufizimeve në qasje, përfshirë kufizimet që rrjedhin nga konfidencialiteti.

### 3. Korniza ligjore e zbatueshme për gjykimet për krime luftime

#### **A. Standardet ligjore të zbatueshme**

Procedurat për krime luftime në Kosovë rregullohen nga një ndërveprim kompleks i regjimeve ligjore, që përfshijnë standardet ndërkombëtare, ligjin e zbatueshëm në Kosovë në kohën e kryerjes së veprës dhe ligjin procedural bashkëkohor. Ky ndërveprim shpjegon pse aktakuzat për krime luftime i referohen akuzave sipas Kodit Penal të RSFJ-së, të cilat janë artikuluar dhe përcaktuar më tej nga KPK.<sup>19</sup>

Ndonëse Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës dhe për rrjedhojë nuk është formalisht e detyruar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 22 i Kushtetutës i jep Konventës zbatim të drejtpërdrejtë dhe epërsi ndaj legjislacionit të Kosovës. Meqenëse Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është interpretuesi autoritativ i Konventës, jurisprudenca e saj është relevante në Kosovë, përfshirë në çështjet penale, veçanërisht kur Kodi Penal i Kosovës përfshin garanci kushtetuese dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>20</sup>

Sa i përket së drejtës materiale, jurisprudenca e TPNJ dhe e gjykatave të Kosovës ka konfirmuar në mënyrë të vazhdueshme se krimet e luftës të kryera gjatë konfliktit në Kosovë rregullohen nga Kodi Penal i RSFJ-së, i interpretuar dhe zbatuar në përputhje me të drejtën ndërkombëtare humanitare.<sup>21</sup> Përkufizimi i krimeve të luftës në Kodin Penal të RSFJ-së ishte përcaktuar në përputhje me Konventat e Gjenevës dhe protokollet shtesë të vitit 1949,<sup>22</sup> meqë Jugosllavia ishte palë nënshkruese e tyre.<sup>23</sup> Gjykata Supreme e Kosovës ka konfirmuar shprehimisht se Kodi Penal i RSFJ-së përbën të drejtën materiale të zbatueshme për këto vepra penale.<sup>24</sup>

#### **B. Korniza për përcaktimin e dënimeve dhe parimi i ligjshmërisë**

Sa i përket dënimeve, Gjykata Supreme e Kosovës ka konfirmuar se në kohën e kryerjes së veprave penale ishte në fuqi Kodi Penal i RSFJ-së. Neni 38 (1) i këtij kodi parashihte se: “dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë ditë, as më i gjatë se pesëmbëdhjetë vjet”, ndërkohë që neni 38 (3) krijoi paqartësi për autoritetet gjyqësore, ngaqë parashihte mundësinë e shqiptimit të dënimit me

---

<sup>19</sup> Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nenet 144–147

<sup>20</sup> *Shih gjithashtu*: Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]: “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.” Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702> [hapur së fundi më 12 qershor 2026].

<sup>21</sup> *Prokurori kundër Millutinoviç dhe të tjerë*, Lënda nr. IT-05-87-T (Dhoma Gjyqësore e GJNPIJ, 26 shkurt 2009), paragrafët 447, 1154, 1155; Gjykata Supreme, pml.nr.26/2023, 2020:017884, 20 mars 2023.

<sup>22</sup> Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (1949), Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollet Shtesë. Të disponueshme në: <https://www.icrc.org/en/law-and-policy/geneva-conventions-and-their-commentaries#text940076> [qasur më 12 qershor 2026]

<sup>23</sup> OSBE (maj 2010), Gjykimet për krime luftime në Kosovë: Vlerësim dhjetë vjet pas, 1999–2009, f. 9.

<sup>24</sup> Shih Aktgjykimin pml. nr. 138/2021 (5 maj 2021)

burgim deri në *njëzet vjet* për format e rënda të kësaj vepre penale.<sup>25</sup> Në vitin 2023, Gjykata Supreme e Kosovës e sqaroi këtë çështje duke theksuar se, në kontekstin aktual të gjykimeve për krime luftime në Kosovë, dënimi maksimal që mund të shqiptohet sipas ligjit është pesëmbëdhjetë vjet burgim.<sup>26</sup>

Gjykata konstatoi se neni 38 (3) i Kodit Penal të RSFJ-së nuk ishte i zbatueshëm dhe, për rrjedhojë, dënimi me njëzet vjet burgim nuk mund të shqiptohej për veprën penale bazë, por vetëm për një formë të rëndë të kësaj vepre të përcaktuar shprehimisht me ligj. Me rëndësi të veçantë është fakti se forma e rëndë e veprës penale duhet të jetë e paraparë *shprehimisht* me ligj dhe nuk mund të barazohet me rrethanat rënduese që lidhen me mënyrën e kryerjes së veprës.<sup>27</sup> Meqë Kodi Penal i RSFJ-së nuk parashihte forma të rënda të kryerjes së krimeve të luftës, dënimi më i lartë që mund të shqiptohet për një vepër penale të cilësuar si krim luftime është pesëmbëdhjetë vjet burgim.

Kjo qasje e Gjykatës Supreme është në përputhje me parimin e ligjshmërisë, siç përcaktohet në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), përfshirë ndalimin e zbatimit prapaveprues të ligjit penal ose të dënim më të rëndë.<sup>28</sup> Pra, kur ekzistojnë dy regjime juridike potencialisht të zbatueshme që janë të papajtueshme ndërmjet tyre, gjykatat duhet të zbatojnë ligjin që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe, kur është e nevojshme, interpretimin më të favorshëm për të pandehurin, duke garantuar njëherazi sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë e dënimit.

### **C. Zhvillimet lidhur me kompetencat dhe kapacitetet institucionale**

Korniza ligjore që rregullon trajtimin e krimeve të luftës të kryera në Kosovë ka pësuar ndryshime ndër vite, duke kaluar nëpër një sërë mekanizmash ligjorë dhe institucionalë. Shtojca A e këtij raporti ofron një pasqyrim të themelimit të gjykatave ndërkombëtare, hibride dhe vendore. Ky raport përqendrohet në gjykimin e rasteve të krimeve të luftës nga Departamenti Special pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatat në janar të vitit 2019.<sup>29</sup> Ligji për Gjykatat riorganizoi sistemin gjyqësor të Kosovës duke themeluar departamente speciale në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, me kompetencë ekskluzive për shqyrtimin e rasteve të krimeve të luftës. Këto departamente u funksionalizuan në qershor të vitit 2019, pas përzgjedhjes së gjyqtarëve përmes një procedure të brendshme konkurruese. Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë është kompetent për gjykimin e lëndëve të

<sup>25</sup> Gazeta Zyrtare e RSFJ, neni 38.

<sup>26</sup> Gjykata Supreme, pml.nr.26/2023, 2020:017884, 20 mars 2023.

<sup>27</sup> Më konkretisht, paragrafi 3 i nenit 38 zbatohet vetëm kur: (i) vepra penale kryhet me dashje; (ii) format e rënda të veprës penale janë të parapara me ligj; dhe (iii) për veprën penale bazë parashihet dënim maksimal prej pesëmbëdhjetë vjetësh. Shih Gjykata Supreme, pml. nr. 26/2023, 2020:017884, 20 mars 2023, f. 7.

<sup>28</sup> Shih *Kononov kundër Letonisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 17 majit 2010, paragrafi 187; *Vasiliasukas kundër Lituanisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 20 tetorit 2015, paragrafët 18, 162 dhe 184. Shih gjithashtu GJEDNJ, Tema kryesore 1: Neni 7 – Krimet ndërkombëtare.

<sup>29</sup> Gazeta Zyrtare, Ligji nr. 06/L-054 për gjykatat.

krimeve të luftës në të cilat shqyrtimi i aktakuzës nuk kishte përfunduar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, kurse lëndët që kishin kaluar tashmë këtë fazë vazhduan të trajtoheshin nga gjykatat para të cilave ato lëndë ishin në procedurë. Ligji për Gjykatat i jep po ashtu kompetencë Departamentit Special për lëndët e kthyera në rigjykim nga Gjykata e Apelit për shkak të shkeljeve procedurale,<sup>30</sup> ndërkohë që ankesat shqyrtohen nga paneli special i Gjykatës së Apelit.<sup>31</sup>

Ngjashëm, sipas Ligjit nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale, Prokurorisë Speciale i është dhënë kompetencë ekskluzive për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Qëkurse është themeluar, EULEX-i i ka transferuar Prokurorisë Speciale afërsisht 900 raste që lidhen me krime lufte, ndërkohë që rreth 2,000 raste të personave të zhdukur janë transferuar nga Njësia për Krime Luftë e Policisë së EULEX-it te Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Luftës në kuadër të Policisë së Kosovës.<sup>32</sup> Në vitin 2019, Këshilli Prokurorial i Kosovës miratoi strategji të posaçme për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës, që rezultoi mes tjerash në themelimin e Departamentit të Specializuar për Hetimin e Krimeve të Luftës në kuadër të Prokurorisë Speciale, me mandat trajtimin e këtyre rasteve.

Zbatimi i strategjisë së vitit 2019 për adresimin e krimeve të luftës vazhdon të përcillet me sfida të konsiderueshme, përfshirë vështirësi politike, burime të kufizuara dhe mungesë bashkëpunimi të mjaftueshëm në nivel ndërkombëtar dhe rajonal. Ndonëse Strategjia e re për krimet e luftës u hartua në vitin 2025 dhe përmendet në Strategjinë për drejtësi tranzicionale 2024–2034, ajo ende nuk është miratuar zyrtarisht, ndërkohë që zbatimi i saj vazhdon të varet nga vullneti politik dhe sigurimi i burimeve të mjaftueshme.<sup>33</sup>

Prokuroria Speciale vazhdon të përballet me ngarkesë të madhe lëndësh. Ndonëse numri i prokurorëve të caktuar në Departamentin për Krime Luftë është rritur gjatë viteve të fundit, në vitin 2025 vetëm pesë prokurorë kishin qenë të angazhuar në ndjekjen penale të rasteve të krimeve të luftës.<sup>34</sup> Ky numër është i pamjaftueshëm duke pasur parasysh vëllimin dhe kompleksitetin e lëndëve të trashëguara dhe atyre në procedurë. Këto kufizime të vazhdueshme kapacitetesh lidhen drejtpërsëdrejti me disa nga sfidat e identifikuar në këtë raport dhe shpalosin nevojën për trajnim të mëtejshëm të specializuar dhe mbështetje shtesë për adresimin e numrit të konsiderueshëm të lëndëve të pazgjidhura.

---

<sup>30</sup> Neni 42 (5), i lexuar në lidhje me nenin 24 (1) (1.1) të Ligjit për gjykatat, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302> [qasur më 12 qershor 2026]

<sup>31</sup> Qendra për të Drejtën Humanitare në Kosovë, *Raporti vjetor* (Prishtinë, 2019), f. 330.

<sup>32</sup> *Strategjia për adresimin e krimeve të luftës*, f. 8

<sup>33</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2024, f. 29. Në dispozicion te: <https://www.ecoi.net/en/file/local/2132161/kosovo-report-2025.pdf> [qasur më 12 qershor 2026].

<sup>34</sup> Qendra për të Drejtën Humanitare (2025), Gjykimet në mungesë për krime lufte: Mes statistikave dhe realitetit të drejtësisë, f. 367. Në dispozicion te: [https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/Gjykimet%20n%C3%AB%20munges%C3%AB%20p%C3%ABr%20krime%20lufte\\_Raporti%202025/Kosovo%20report%202025%20ALB%20SRB%20ENG.pdf](https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/Gjykimet%20n%C3%AB%20munges%C3%AB%20p%C3%ABr%20krime%20lufte_Raporti%202025/Kosovo%20report%202025%20ALB%20SRB%20ENG.pdf) [qasur më 12 qershor 2026].

Përparimi në ndjekjen penale të krimeve të luftës vazhdon të pengohet edhe nga mungesa e ndihmës juridike efektive në nivel rajonal.<sup>35</sup> Megjithatë, Prokuroria Speciale ka vazhduar të trajtojë lëndë komplekse që lidhen me shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të qëndrueshëm institucional dhe respektimit të pavarësisë së gjyqësorit. Përpyqjet për njohjen dhe kompensimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale të ndërlidhur me konfliktin kanë vazhduar po ashtu. Megjithatë, përkundër këtyre përpjekjeve, qasja në drejtësi vazhdon të jetë e kufizuar për shkak të stigmës shoqërore dhe kriterëve kufizues të kualifikimit për kompensim.<sup>36</sup>

## 4. Gjetjet

### A. Vrojtime të përgjithshme rreth rasteve të monitoruara



Që nga themelimi i Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë në janar të vitit 2019, aktakuzë është ngritur në 48 lëndë me pretendime për krime lufte të kryera në Kosovë. Në këto lëndë ishin përfshirë gjithsej 138 të pandehur, duke qenë se disa aktakuza ishin ngritur kundër më shumë se një personi. Deri më 31 dhjetor të vitit 2025, 17 prej këtyre lëndëve kishin përfunduar me aktgjykime të plotfuqishme, që përbën një shkallë të përfundimit të lëndëve prej 35 për qind gjatë periudhës referuese.

Nga 17 lëndët e gjykuara nga Departamenti Special, 15 ishin me aktgjykim dënues, ndërsa vetëm në dy sosh u shpall aktgjykim lirues,<sup>37</sup> çka përfaqëson shkallë të lartë dënimi prej 88 për qind.

Sa i përket përbërjes gjinore, që të gjithë personat e akuzuar për krime lufte në mostrën e analizuar ishin burra. Për sa i përket përkatësisë etnike, 68 për qind e rasteve kishin të bënin me serbë,<sup>38</sup> kurse 24 për qind përfshinin serbë të Kosovës.<sup>39</sup> Megjithatë, duhet theksuar se disa aktakuza të ngritura në mungesë janë ende konfidenciale dhe nuk

<sup>35</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2024, f. 29.

<sup>36</sup> Strategjia për drejtësi tranzicionale 2024–2034.

<sup>37</sup> Përqindja e aktgjykimeve dënuese është llogaritur mbi bazën e 17 lëndëve që janë gjykuar dhe konfirmuar nga Departamenti Special gjatë periudhës 1 janar 2019 – 31 dhjetor 2025. Konkretisht, 15 lëndë patën si epilog aktgjykim dënues, ndërsa vetëm në dy sosh u shpall aktgjykim lirues.

<sup>38</sup> Të cilët jetojnë jashtë Kosovës.

<sup>39</sup> Informatat për këtë analizë janë nxjerrë nga 29 aktakuzat që OSBE-ja kishte në dispozicion, të cilat përfshinin 87 të pandehur.

kanë kaluar ende në fazën e gjykimit, rrjedhimisht të dhënat për përkatësinë gjinore dhe etnike të të akuzuarve në këto raste nuk janë të disponueshme.



Këto vrojtime të përgjithshme shërbejnë si kontekst për gjetjet tematike të paraqitura në vijim. Ndërkohë që gjetjet shpalosin aktivitet të shtuar të institucioneve vendore në gjykimin e rasteve të krimeve të luftës, monitorimi i OSBE-së ka identifikuar një sërë sfidash të përsëritura procedurale dhe strukturore, që janë paraqitur në vijim.

## **B. Vonesat e zgjatura në gjykimet për krime lufte**

### **i. Respektimi i së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm**

Neni 5 i KPP-së është në përputhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, që përcakton se çdo person ka të drejtë që çështja e tij *“të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm”*.<sup>40</sup> GJEDNJ ka konstatuar se, për qëllime të llogaritjes së “afatit të arsyeshëm” të një gjykimi, periudha përkatëse fillon nga dita kur një person akuzohet<sup>41</sup> dhe përfundon me lirimin nga akuza ose me shpalljen përfundimtare të aktgjykimit dënues ose lirues, përfshirë këtu edhe fazën e ankimimit.<sup>42</sup> Ndonëse nuk ekziston afat i përcaktuar në mënyrë strikte, vlerësimi nëse procedura është zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm bazohet në një sërë faktorësh, përfshirë kompleksitetin e rastit, sjelljen e parashtruesit dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse administrative dhe gjyqësore.<sup>43</sup>

KPP-ja përmban disa dispozita të konceptuara për të garantuar respektimin e së drejtës për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm nga gjykatat e Kosovës.

<sup>40</sup> Shih po ashtu nenin 5(3) të KEDNJ-së.

<sup>41</sup> *Shih Neumeister kundër Austrisë*, Aktgjykim i GJEDNJ i 27 qershorit 1968, paragrafi 18.

<sup>42</sup> *Shih Wemhoff kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i GJEDNJ i 27 qershorit 1968, paragrafi 18.

<sup>43</sup> *König kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i GJEDNJ i 28 qershorit 1978, paragrafi 99.

Këto dispozita zbatohen për të gjitha procedurat penale. Megjithatë, për nga natyra e tyre, gjykimet për krime lufte karakterizohen nga shkallë e lartë kompleksiteti.

Për më tepër, në shumë lëndë të krimeve të luftës shpesh paraqitet nevoja për përkthimin e një vëllimi të madh provash dhe dokumentesh procedurale për t'iu përgjigjur nevojave gjuhësore të palëve të përfshira. Këto raste zakonisht përfshijnë edhe numër të madh dëshmitarësh, çka e shton më tej kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e procedurës.

Ndonëse OSBE i ka parasysh këto sfida strukturore dhe procedurale, GJEDNJ ka theksuar vazhdimisht se, edhe kur kompleksiteti i një lënde mund të arsyetojë kohëzgjatje më të madhe të procedurës, autoritetet gjyqësore kanë detyrimin pozitiv që sistemin gjyqësor ta organizojnë në mënyrë të tillë që të garantohet respektimi i kërkesës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,<sup>44</sup> veçanërisht në situatat kur i akuzuari është i privuar nga liria.<sup>45</sup> Vonesat procedurale në rastet e krimeve të luftës kanë pasoja thelbësisht të ndryshme nga ato në lëndët e zakonshme penale, sidomos kur merret parasysh fakti se shumica dërrmuese e të akuzuarve, thuajse 95 për qind, mbahen në paraburgim. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, tejkalimi i afateve procedurale të përcaktuara me ligj, kur i atribuohet veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve gjyqësore, mund të përbëjnë shkelje të së drejtës së të akuzuarit për proces të rregullt brenda afatit të arsyeshëm.<sup>46</sup>

OSBE ka identifikuar disa shkaqe të përsëritura të vonesave në rastet e monitoruara të krimeve të luftës, që janë shtjelluar në hollësi më poshtë.

## ii. Shkaqet kryesore të vonesave të evidentuara

### **Mosparaqitja e dëshmitarëve**


OSBE ka evidentuar raste të shumta të mosparaqitjes së dëshmitarëve në gjykatë, përkundër faktit se ishin ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata me propozim të prokurorisë ose të mbrojtjes. Më konkretisht, nga 25 lëndë që kaluan në fazën e gjykimit dhe përfshinin të paktën një seancë për administrim të provave, në 13 sosh u shkaktuan vonesa për shkak të mosparaqitjes së dëshmitarit. Kur analiza bëhet në nivel të seancave dhe jo të lëndëve, rezulton se 33 nga 158 seanca për administrimin e provave (21 për qind) u shtynë për shkak të mosparaqitjes së të paktën një dëshmitari.

---

<sup>44</sup> Ivana Roagna, "E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm sipas nenit 6 të KEDNJ-së: Udhëzues praktik", (2018), f.29

<sup>45</sup> Kalashnikov kundër Ruisisë, 15 korrik 2002, paragrafët 132-134.

<sup>46</sup> GJEDNJ ka theksuar se mosrespektimi i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm (në shkelje të nenit 6(1) të KEDNJ-së) konstatohet vetëm në rastet kur veprimet ose mosveprimet e autoriteteve vendore apo organeve kompetente shtetërore kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në vonesat dhe shtyrjet e procedurës. Në të kundërtën, kur konsiderohet se vetë parashtruesi i kërkesës (i pandehuri në procedurë penale) ka kontribuar në zgjatjen e procedurës, qoftë duke penguar zhvillimin e hetimeve penale dhe duke kërkuar shtyrje të shumta, qoftë duke paraqitur "kërkesa të shumta për anulim dhe pretendime të pabazuara për anshmëri", GJEDNJ i konsideron pretendime të tilla si të pabazuara. *Shih Lammi kundër Finlandës*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 15 shkurtit 2006.



Në total, gjatë periudhës janar 2019 – dhjetor 2025, 52 dëshmitarë nuk janë paraqitur ose janë paraqitur me vonesë në gjykimet për krime lufte. Arsyet e mungesave janë të ndryshme, siç pasqyrohet në grafikun më sipër. Një pjesë e konsiderueshme e tyre (22 për qind) lidhej me arsye shëndetësore. Disa dëshmitarë përmendën moshën e shtyrë si faktor që ua kufizonte mundësinë për të udhëtuar dhe për të marrë pjesë në seancat para Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndërsa të tjerë evidentuan mosbanimin në Prishtinë. Në këtë drejtim, OSBE e vlerëson pozitivisht faktin se në disa raste është mundur dhënia e dëshmisë përmes videolidhjes, me qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes së dëshmitarëve. Megjithatë, kjo mundësi është e kufizuar vetëm për dëshmitarët që ndodhen në Kosovë ose në lokacione ku ekzistojnë mekanizma efektivë bashkëpunimi me gjykatat e Kosovës. Si rrjedhojë, disa dëshmitarë, përfshirë një pjesë të madhe të dëshmitarëve të mbrojtjes që banojnë në vende me të cilat nuk ekzistojnë marrëveshje të tilla bashkëpunimi, nuk kanë mundur të japin dëshmi përmes videolidhjes. Për këtë arsye, ata ose nuk kanë dhënë fare dëshmi, ose deklaratat e tyre janë lexuar në procesverbal.<sup>47</sup>

GJEDNJ ka konstatuar se gjykatat mbajnë përgjegjësi për të siguruar paraqitjen e pjesëmarrësve të nevojshëm në procedurën gjyqësore, përfshirë dëshmitarët, të bashkëpandehurit dhe përfaqësuesit, në situatat kur mosparaqitja e tyre çon në shtyrje të seancave.<sup>48</sup> Ndërkohë që mosha e shtyrë e disa dëshmitarëve është faktor jashtë kontrollit të palëve dhe lidhet drejtpërdrejt me periudhën kohore ndërmjet

<sup>47</sup> Informacion i dhënë nga disa avokatë mbrojtës gjatë gjykrimeve dhe i konfirmuar gjatë një interviste të realizuar nga OSBE-ja me një avokat mbrojtës më 25 nëntor 2025.

<sup>48</sup> *Shih Tychko kundër Rusisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 11 qershorit 2015, paragrafi 68. *Shih po ashtu* Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2022), paragrafi 341.

ngjarjeve të pretenduara dhe zhvillimit të gjykimit, shkaqet e tjera të mosparaqitjes mund të adresohen nga gjykata dhe nga palët që kanë propozuar dëshmitarët. Në këtë drejtim, disa dëshmitarë kanë përmendur vështirësitë me transportin, përfshirë koston e udhëtimit deri në gjykatë dhe mospagimin në kohë të ndihmës financiare për organizimin e transportit. Për më tepër, rreth 14 për qind e dëshmitarëve që nuk janë paraqitur nuk kanë dhënë asnjë arsyetim për mungesën e tyre. Në raste të tilla, gjykatat janë detyruar të kërkojnë shoqërimin e dëshmitarëve nga policia e, në disa raste, madje edhe vizita të policisë në vendbanimet e tyre për të siguruar paraqitjen në gjykatë. Kjo praktikë ka kosto të konsiderueshme administrative dhe flet për vështirësitë praktike në sigurimin e paraqitjes së dëshmitarëve, veçanërisht në rastet kur ata nuk janë plotësisht të informuar për detyrimet e tyre procedurale ose për masat mbështetëse që kanë në dispozicion.

Në disa raste, dëshmitarët paraqiten para gjykatës, por për shkak të problematikave që lidhen me administrimin e lëndës u kërkohet të kthehen për të dhënë dëshmi në një datë të mëvonshme. Shtyrje të tilla mund të krijojnë barrë të panevojshme dhe të shmangshme për dëshmitarët, si dhe të ndikojnë negativisht në besimin e publikut në procesin gjyqësor.

Për shembull, në një rast, një dëshmitar kundërshtoi kërkesën për t'u paraqitur sërish në një seancë të mëvonshme, duke shpjeguar se ishte thirrur disa herë, se kishte vështirësi financiare për t'i mbuluar shpenzimet e transportit për një udhëtim prej gati 100 kilometrash në një drejtim dhe se ishte në regjim mjekësor. Dëshmitari theksoi gjithashtu se gjykata nuk ia kishte rimbursuar shpenzimet e bëra më parë, pavarësisht detyrimit ligjor për rimbursimin e tyre.<sup>49</sup> Një situatë e tillë ngre shqetësime edhe lidhur me respektimin e nenit 63 (1) (1.16) të KPP-së, sipas të cilit dëshmitarëve në cilësinë e palës së dëmtuar ose të viktimës u garantohej drejta për kompensim dhe rimbursim të shpenzimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja e tyre në procedurë penale. Një situatë e tillë nxjerr gjithashtu në pah rrezikun që mbështetja e pamjaftueshme të pengojë pjesëmarrjen e dëshmitarëve dhe të cenojë integritetin e procedurës.

OSBE i inkurajon institucionet gjyqësore që t'i shtojnë përpjekjet për ta informuar publikun e gjerë lidhur me të drejtat dhe detyrimet që gëzojnë personat e ftuar për t'u paraqitur si dëshmitarë, përfshirë mundësinë e ndihmës financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit. Informimi më i mirë dhe ofrimi në kohë i mbështetjes do të ndihmonin në uljen e vonësive procedurale dhe në lehtësimin e barrës për autoritetet e zbatimit të ligjit.

---

<sup>49</sup> Sipas nenit 449 dhe neneve 451–456 të KPP-së, dëshmitarët përfshihen shprehimisht si pjesëmarrës në procedurë shpenzimet e të cilëve hyjnë në kuadër të shpenzimeve të procedurës penale. Kjo i detyron institucionet kompetente të mbulojnë shpenzimet e nevojshme, përfshirë shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzimet e tjera që lidhen me pjesëmarrjen e tyre, ndonëse KPP-ja nuk përmban një nen të veçantë që u kushtohet posaçërisht dëshmitarëve.

## **Ndryshimet në përbërjen e trupit gjykues**

Siç u theksua më lart, procedurat për krime lufte janë veçanërisht komplekse për nga vetë natyra. Këto procedura zakonisht përfshijnë numër të madh dëshmitarësh, material voluminoz provues dhe faza procedurale të stërzgjatura. OSBE ka evidentuar raste të shumta në të cilat mangësitë në administrimin e lëndëve kanë kontribuar në vonesa të konsiderueshme. Ndonëse disa nga këto vonesa mund të jenë pasojë e faktorëve jashtë kontrollit të institucioneve gjyqësore, në raste të caktuara është e mundshme të ndërmerren masa konkrete për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe efikas të gjykimeve.

Një nga burimet e përsëritura të vonesave, i evidentuar nga monitorimi i OSBE-së, është ndryshimi në përbërjen e trupave gjykues, veçanërisht në rastet kur nuk ekziston mekanizëm i institucionalizuar për të siguruar vazhdimësinë ose ruajtjen e njohurive për lëndën pas zëvendësimit të anëtarëve. Ndryshime të tilla shpesh sjellin shtyrje të seancave, qoftë për shkak se anëtarëve të rinj të trupit gjykues u nevojitet kohë për t'i shqyrtuar dëshmitë e dhëna më parë dhe procesverbalet e seancave, qoftë sepse gjykimi duhet të fillojë nga e para për shkak të ricaktimit të trupit gjykues. Edhe në rastet kur procedura nuk ka filluar nga e para, ndryshimi në përbërjen e trupit gjykues shpesh ka shkaktuar vonesa dy-tre mujore deri në caktimin e seancës së radhës. Në rastet kur gjykimi është dashur të fillojë nga e para, vonesat kanë qenë dukshëm më të mëdha, veçanërisht në lëndët që kishin qenë në procedurë për disa vite. Monitorimi i OSBE-së tregon se kjo ka ndodhur në më shumë se 24 për qind të rasteve (gjashtë nga njëzet e pesë lëndë) që kanë kaluar në gjykim.

Si ilustrim, në një lëndë, procedura u pezullua për rreth tre muaj, nga korriku deri në tetor 2024, pas ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues. Në po të njëjtën lëndë, në shtator 2025 ndodhi një ndryshim i dytë në përbërjen e trupit gjykues, pas të cilit gjykata urdhëroi që gjykimi të fillonte nga e para. Vlen të theksohet se i akuzuari ndodhej në paraburgim që nga dhjetori i vitit 2022, ndërsa lënda u përfundua me aktgjykim dënues më 26 dhjetor 2025.

Në shumicën e lëndëve të përmendura më sipër (67 për qind), ndryshimet në përbërjen e trupit gjykues ndodhën si rrjedhojë e emërimit të gjyqtarëve në instanca të tjera gjyqësore, kurse ndryshimet e tjera mund të kenë qenë rezultat i lëvizjeve të brendshme administrative. Ndërkohë që emërimet e tilla janë në masë të madhe të pashmangshme, OSBE e inkurajon Këshillin Gjyqësor të Kosovës të ndërmarrë masa për zbutjen e ndikimit të tyre në procedurat që tashmë janë në zhvillim e sipër, përfshirë mundësinë e shtyrjes së transferimit të gjyqtarit deri në përfundim të gjykimit, në mënyrë që të mbrohet e drejta e të akuzuarit për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Ndryshimet legislative që do të parashihnin caktimin e gjyqtarëve zëvendësues në procedura komplekse dhe të gjata, siç janë lëndët e krimeve të luftës, mund të shërbejnë po ashtu si mekanizëm i fuqishëm për kufizimin e

ndërprerjeve, forcimin e vazhdimësisë dhe efikasitetit, si dhe garantimin e të drejtave të të akuzuarit për proces të rregullt.

### **Transportimi i të akuzuarve të paraburgosur**

Një aspekt tjetër i lidhur me menaxhimin e lëndëve, që përfshin drejtpërdrejt autoritetet e paraburgimit, ka të bëjë me vonesat e shkaktuara nga bashkërendimi i pamjaftueshëm për transportimin e të akuzuarve nga institucionet e paraburgimit drejt gjykatës. Në shumicën e rasteve, këto vonesa zgjasin vetëm disa orë, por ka pasur edhe raste kur i akuzuari nuk është sjellë fare në gjykatë, gjë që ka detyruar shtyrjen e seancës.

Edhe vonesat e shkurtra mund të ndikojnë negativisht në efikasitetin e procedurës, sidomos në rastet kur në gjykatë janë të pranishëm dëshmitarët, por seanca nuk mund të vazhdojë për shkak të mungesës së të akuzuarit ose vonesës në transferimin e tij. Kjo situatë e bën të domosdoshëm caktimin e një date tjetër për dëgjimin e dëshmitarëve.

Monitorimi i OSBE-së tregon se në rreth 30 për qind të lëndëve që kanë kaluar në gjykim dhe kanë përfshirë të akuzuar në paraburgim, të paktën një seancë është vonuar për shkak se institucioni i paraburgimit nuk ka arritur ta sigurojë shoqërimin në kohë të të paraburgosurit. Vonesa të tilla ndikojnë negativisht në të drejtën e të akuzuarit për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së, dhe cenojnë kërkesën e nenit 5(3), që procedurat të zhvillohen me kujdes të posaçëm në rastet kur i akuzuari mbahet në paraburgim. Prandaj, forcimi i bashkërendimit, kapaciteteve dhe parashikueshmërisë në transportimin e personave të paraburgosur është thelbësor për parandalimin e vonesave të shmangshme dhe për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

### **Vonesat në zbulimin e provave**

Sipas nenit 239 të KPP-së, prokuroria është e detyruar t'ia zbulojë mbrojtjes provat në të cilat mbështetet aktakuza, si dhe të gjitha materialet e mbledhura gjatë fazës hetimore të procedurës.<sup>50</sup> Ky detyrim përfshin si provat inkriminuese ashtu edhe ato shfajësuese në lidhje me të akuzuarin dhe me dëshmitarët e intervistuar gjatë hetimit. Në përputhje me nenin 239(2) të KPP-së, materialet e tilla duhet të vihen në dispozicion në një gjuhë që e kupton i pandehuri. GJEDNJ-ja ka mbajtur vazhdimisht qëndrimin se moszbulimi i materialeve përkatëse në kohën e duhur, duke përfshirë provat shfajësuese, mund të minoj drejtësinë e procedurave në tërësi, veçanërisht kur vonesat e tilla ndikojnë në aftësinë e mbrojtjes për të përgatitur rastin në mënyrë efektive.<sup>51</sup>

---

<sup>50</sup> Gazeta Zyrtare (17 gusht 2022) Kodi Nr. 08/L -032, Kodi i Procedurës Penale, neni 239

<sup>51</sup> GJEDNJ: Mirilashvili kundër Ruisisë, Kërkesa nr. 6293/04, Aktgjykimi i 11 dhjetorit 2008, par. 204; Rowe dhe Davis kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 28901/95, 16 shkurt 2000, paragrafët 54, 66; Edwards dhe Lewis kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesat nr. 39647/98 dhe 40461/98, 27 tetor 2004, par. 34.

OSBE-ja ka vërejtur se një numër seancash dëgjimore janë shtyrë për shkak se prokuroria nuk ishte e gatshme ose nuk ishte në gjendje të zbulonte materialet shfajësuese ose fajësuese në lidhje me dëshmitarët në kohën e duhur. Vonesat në zbulimin e provave shpesh rëndohen nga përkthimi i vonuar i deklaratave të dëshmitarëve dhe materialeve të tjera provuese. Konkretisht, 7 për qind e seancave dëgjimore u shtynë për shkak të vonesave në zbulimin e provave, në kundërshtim me kriteret e nenit 239 të KPP-së. Këto vonesa prekën 11 raste, që përfaqësojnë gati gjysmën e rasteve të krimeve të luftës që kanë vazhduar në gjykim.

Zbulimi dhe përkthimi i vonuar i materialit provues ka ndikuar në procedura në faza të ndryshme të gjyimit. Në disa raste, mbrojtja ka treguar se nuk ka qenë në gjendje që të deklarohet rreth fajësisë sepse dokumentet kryesore të përkthyer nuk gjendeshin në shkresat e lëndës. Kjo ngre shqetësime që lidhen me nenin 6 (3)(a) të KEDNJ-së, i cili ia garanton të akuzuarit të drejtën për t'u informuar menjëherë dhe në hollësi, në gjuhë që e kupton, mbi natyrën dhe shkakun e akuzës. Në një rast tjetër, avokati mbrojtës kundërshtoi kur provat në të cilat është mbështetur prokuroria, ose të cilave dëshmitarët u janë referuar gjatë marrjes në pyetje, nuk ishin zbuluar paraprakisht. Si pasojë, mbrojtja kërkoi qasje në material dhe kohë shtesë për t'u përgatitur për marrjen në pyetje të tërthortë. Kjo është në kundërshtim me të drejtën e të akuzuarit për të pasur kohë dhe lehtësira të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes sipas nenit 6(3)(b) të KEDNJ-së.

Një zbulim i tillë i vonshëm jo vetëm që pengoi zhvillimin e procedurave, por kërkoi edhe anulimin e dëshmitarëve, duke i rënduar edhe më tej vonesat. GJEDNJ-ja ka konstatuar se mangësitë në zbulimin e provave që kërkojnë shtyrje ose dëmtojnë aftësinë e mbrojtjes për të testuar provat përmes marrjes në pyetje të tërthortë në mënyrë efektive, mund të prishin ekuilibrin midis palëve dhe të ndikojnë në drejtësinë e përgjithshme të gjyimit.<sup>52</sup>

Shqetësime të tjera kanë lindur në lidhje me shqyrtimin e provave nga personat e akuzuar të mbajtur në paraburgim. Siç është theksuar në disa raste dhe është ngritur nga avokatët mbrojtës gjatë takimeve konsultative, të akuzuarit e paraburgosur janë përballur me pengesa të konsiderueshme praktike lidhur me qasjen në shkresat e lëndëve voluminoze. Këto sfida janë veçanërisht të theksuara në lidhje me provat në formë video materialesh, pasi që qendrat e paraburgimit shpesh nuk kanë infrastrukturë teknike dhe pajisje për trajtimin e sigurt të provave të ndjeshme, gjë që e pengon avokatin mbrojtës dhe të akuzuarin që të shqyrtojnë materialet e tilla së bashku. Vlen të përmendet se, në jurisprudencën e GJEDNJ-së, koncepti i "lehtësirave adekuate" sipas nenit 6(3)(b) përfshin aranzhime praktike që ia mundësojnë të akuzuarit të shqyrtojë provat kundër tij, veçanërisht kur materialet janë voluminoze ose teknikisht komplekse.<sup>53</sup>

---

<sup>52</sup> *Natunen kundër Finlandës*, Aplikimi nr. 21022/04, 31 mars 2009, par. 42.

<sup>53</sup> *Moiseyev kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 62936/00, 9 tetor 2003, paragrafët 209, 219-223.

Si ilustrim, gjatë një seance dëgjimore në vitin 2025, avokati mbrojtës kërkoi që gjykata të sigurojë kopje të të gjitha materialeve të shkresave të lëndës në lidhje me një dëshmitar të thirrur nga prokuroria, me qëllim përgatitjen e duhur për marrjen në pyetje të tërthortë. Kryetari i Trupit Gjykses vuri në dukje se dosja e rastit përfshinte rreth 16,000 faqe dhe se qendra e paraburgimit nuk i kishte kushtet e nevojshme për t'ua siguruar të akuzuarve një vëllim të tillë materialesh. Në mungesë të masave kompensuese, kufizimet e tilla rrezikojnë të dëmtojnë ushtrimin efektiv të drejtave të mbrojtjes dhe ngrenë shqetësime në lidhje me pajtueshmërinë me garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së.

### **C. Qartësia e akuzave dhe cilësia e aktakuzës**

Standardet ndërkombëtare dhe vendore kërkojnë që akuzat penale të formulohen me qartësi dhe detaje të mjaftueshme për t'ia mundësuar të akuzuarit që ta kuptojë natyrën dhe shkakun e akuzave dhe të përgatisë mbrojtje efektive. Sipas nenit 14(3)(a) të Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike (ICCPR) dhe nenit 6(3)(a) të KEDNJ-së, i pandehuri duhet të informohet menjëherë dhe në hollësi, në gjuhë që ai e kupton, si për karakterizimin ligjor të veprës penale ashtu edhe për bazën e saj thelbësore faktike. Komiteti për të drejtat e njeriut ka sqaruar më tej se akuzat e paqarta ose tepër të gjera mund ta dëmtojnë efektivitetin e së drejtës për mbrojtje.<sup>54</sup> Këto garanci përbëjnë pjesë të së drejtës më të gjerë për proces të rregullt dhe duhet të vlerësohen në mënyrë kumulative me garancitë tjera procedurale. Neni 235 i KPP-së i pasqyron këto standarde ndërkombëtare duke kërkuar që aktakuzat të përcaktojnë rrethanat faktike në të cilat mbështesin akuzat, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese përkatëse, duke garantuar kështu si sigurinë juridike ashtu edhe drejtësinë procedurale.

#### **i. Individualizimi i akuzave dhe shqyrtimi i rrethanave lehtësuese në aktakuzat për krime lufte**

OSBE-ja vëren se aktakuzat e ngritura nga ZPS-ja për krime lufte<sup>55</sup> kanë treguar përmirësime të dukshme në pajtueshmërinë me kriteret e nenit 235 të KPP-së gjatë viteve të kaluara, veçanërisht në lidhje me përshkrimin e sjelljes së akuzuar. Pavarësisht këtij progresi, OSBE-ja ka identifikuar dy shqetësime të vazhdueshme: nevojën për individualizim më të qartë të akuzave dhe mungesën e identifikimit të rrethanave lehtësuese nga prokuroria.

Së pari, në aktakuzat në dispozicion për shqyrtim që përfshinin të pandehur të shumtë, OSBE-ja ka vërejtur shqetësimin rreth mungesës së individualizimit të

---

<sup>54</sup> Komiteti i OKB-së për të drejtat e njeriut, Komenti i përgjithshëm nr. 32 (2007), neni 14: E drejta për barazi para gjykatave dhe tribunaleve dhe për gjykim të drejtë, CCPR/C/GC32 par. 31. Në dispozicion në: <https://digitallibrary.un.org/record/606075?ln=en&v=pdf> [qasur më 12 qershor 2026]

<sup>55</sup> Kjo pjesë bazohet në analizën e 27 aktakuzave në dispozicion të OSBE-së. Aktakuzat për 21 rastet e tjera nuk ishin në dispozicion të OSBE-së për arsye të ndryshme, përfshirë konfidencialitetin.

akuzave dhe sjelljes së akuzuar, në lidhje me secilin të akuzuar. Individualizimi i tillë është thelbësor për t'ia mundësuar secilit të pandehur që ta kuptojë, me saktësi të mjaftueshme, natyrën e akuzave dhe rastin për të cilin duhet të përgjigjet. Derisa kjo mangësi është më pak e theksuar në aktakuzat që përfshijnë dy të pandehur, ajo bëhet dukshëm më problematike në rastet që përfshijnë tre a më shumë të pandehur, ku mungesa e diferencimit rrezikon të mjegullojë përgjegjësinë individuale.

Nga pesë aktakuzat që përfshinin shumë të pandehur dhe që ishin në dispozicion të OSBE-së për shqyrtim, tre (pra, 60 për qind e atij nën-grupi) u identifikuan si pamjaftueshëm të individualizuara. Derisa numri i aktakuzave është i kufizuar, këto tre aktakuza akuzuan kolektivisht rreth 60 individë, duke i zmadhuar kështu në mënyrë drastike implikimet e mangësive të identifikuara për gjykim të drejtë.

Në një rast, një numër i madh i të pandehurve u akuzuan për ndërmarrje të përbashkët kriminale si lloj i përgjegjesisë. Derisa ky lloj i përgjegjesisë është në thelb kolektiv, standardet ndërkombëtare kërkojnë megjithatë shkallë të lartë të deklarimit faktik të individualizuar. Natyra kolektive e akuzës nuk e liron prokurorinë nga detyrimi për të specifikuar, në lidhje me secilin të akuzuar, rolin dhe kontributin e pretenduar në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, faktet materiale që mbështesin atë kontribut dhe bazën mbi të cilën i akuzuari pretendohet se ka qenë pjesë e qëllimit të përbashkët kriminal. Kjo kërkesë ligjore rrjedh nga e drejta e të akuzuarit për t'u informuar menjëherë dhe në detaje për natyrën dhe shkakun e akuzave, siç garantohet nga neni 14(3)(a) i PNDKP-së dhe neni 6 (3)(a) i KEDNJ-së, dhe siç është pohuar vazhdimisht në jurisprudencën penale ndërkombëtare.<sup>56</sup>

Shqetësimi i dytë i identifikuar nga OSBE-ja lidhet me mënyrën se si trajtohen rrethanat lehtësuese në aktakuzat e shqyrtuara. Ndonëse vlerësimi i rrethanave lehtësuese është në fund të fundit çështje për trupin gjykues në fazën e caktimit të dënimit, dhe derisa rrethana të tilla mund të mos ekzistojnë ose të mos jenë të identifikueshme në çdo rast kur ngritet aktakuza, neni 235 i KPP-së kërkon që prokuroria të identifikojë çdo rrethanë të tillë që është e njohur ose në mënyrë të arsyeshme e dukshme në atë fazë. Në praktikë, 89 për qind e aktakuzave të shqyrtuara (24 nga 27) nuk identifikuan rrethana konkrete lehtësuese, por në vend të kësaj u mbështetën në formulim standard duke e ftuar gjykatën thjesht që të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në përputhje me ligjet në fuqi. Derisa kjo, në vetvete, nuk vërteton se kanë ekzistuar rrethana lehtësuese në secilin rast, mbështetja e shpeshtë në formulime të përgjithshme ngre shqetësimin nëse kriteret e nenit 235 janë duke u trajtuar në mënyrë kuptimplotë. Mungesa e

---

<sup>56</sup> TPNJ, *Prokurori kundër Kupreškić et al.*, Dhoma e Apelit, Aktgjykimi i 23 tetorit 2001, par. 88; *Prokurori kundër Kvočka et al.*, Dhoma e Apelit, Aktgjykimi i 28 shkurtit 2005, paragrafët 28, 42–54; *Prokurori kundër Krajišnik*, Dhoma e Apelit, Aktgjykimi i 17 marsit 2009, par. 215; GJEDNJ: *Mattocchia kundër Italisë*, Kërkesa nr. 23969/94, 5 korrik 200, paragrafët 60, 65.

informacionit specifik për rastin mund ta kufizojë aftësinë e gjykatës për të vlerësuar plotësisht rrethanat e të akuzuarit dhe gjithashtu mund të jetë e rëndësishme në fazën paraprake të gjykimit, duke pasur parasysh se aktakuza shpesh shërben si bazë për kërkesat për paraburgim.

## ii. Lloji i përgjegjesisë i përmendur në aktakuza

Shqyrtimi i 27 aktakuzave në dispozicion të monitoruesve të OSBE-së tregon që më shumë se 70 për qind e personave të akuzuar akuzohen për bashkëkryerje si lloji i përgjegjesisë. Derisa kjo qasje nuk është e pazakontë në ndjekjet penale të krimeve të luftës, meqë veprat e tilla penale shpesh kryhen brenda strukturave ose grupeve të organizuara, OSBE-ja vëren se në shumicën e rasteve të akuzuara për bashkëkryerje (afërsisht 75 për qind), identiteti i bashkëkryerës(ve) të dyshuar mbetet i panjohur në aktakuzë.

Në një numër të kufizuar aktakuzash, ofrohen informacione shtesë në lidhje me bashkë-kryerësit e dyshuar, të tilla si pozitat, gradat ose vendndodhja e tyre e përgjithshme. Megjithatë, në shumicën e rasteve, aktakuzat i referohen vetëm bashkë-kryerësve të paidentifikuar, pa saktësime të mëtejshme. Kjo mungesë saktësie krijon sfida për mbrojtjen në përgatitjen adekuate të rastit, pasi akuzat mbeten të paqarta në lidhje me sjelljen e supozuar të përbashkët. Në të njëjtën kohë, kjo paraqet vështirësi edhe për prokurorinë, pasi atribuimi dhe përcaktimi i përgjegjesisë penale individuale në kontekstin e konfliktit të armatosur është në thelb kompleks.

Tribunalet penale ndërkombëtare kanë zhvilluar kritere të hollësishme që janë rafinuar më tej përmes jurisprudencës së gjerë për të adresuar llojet e përgjegjesisë që zbatohen për krimet e kryera në kontekstin e konfliktit të armatosur. Këto përfshijnë, ndër të tjera, doktrinën e ndërmarrjes së përbashkët kriminale siç është zhvilluar nga TPNJ dhe konceptin e planit të përbashkët ose qëllimit të përbashkët në kuadër të Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Këto doktrina përcaktojnë elementë ligjorë të përkufizuar qartë, pragje provash që duhet të përmbushen nga prokuroria dhe rrugë përkatëse për kundërshtimet e mbrojtjes.<sup>57</sup>

Në këtë drejtim, OSBE-ja konsideron se Gjykata Supreme duhet të ofrojë sqarime dhe udhëzime të mëtejshme mbi llojet e zbatueshme të përgjegjesisë për krimet e luftës. Kjo do të kontribuonte në rritjen e sigurisë juridike, do të zvogëlonte paqartësinë në praktikat e akuzimit dhe do të ndihmonte për të siguruar që, si akuzat ashtu edhe çdo dënim që rrjedh nga to, të pasqyrojnë me saktësi sjelljen e pretenduar.

---

<sup>57</sup> *Shih* për shembull, TPNJ: *Prokurori kundër Brđanin* (Dhoma e Apelit, Aktgjykimi i 3 prillit 2007); *Prokurori kundër Kvočka et al.* (Dhoma e Apelit, Aktgjykimi i 28 shkurtit 2005); Antonio Cassese, *International Criminal Law*, 2nd ed. (Oxford University Press, 2008), *shih* në veçanti Kapitullin 12: "Llojet e përgjegjesisë", pjesa për ndërmarrjen e përbashkët kriminale.

## **D. Sfidat në lidhje me provat në gjykimet e krimeve të luftës**

Strategjia e prokurorisë për krimet e luftës e vitit 2025 i kushton rëndësi të veçantë detyrimit të prokurorëve dhe hetuesve për të marrë të gjitha masat e nevojshme, në përputhje me KPP-në, për të siguruar, ruajtur dhe paraqitur provat në atë mënyrë që siguron pranueshmërinë e tyre para gjykatave.<sup>58</sup> Ky fokus është në përputhje me standardet ndërkombëtare që rregullojnë provat në gjykimet e krimeve të luftës, të cilat kërkojnë qasje fleksibile ndaj pranueshmërisë së bashku me vlerësimin e kujdesshëm gjyqësor të rëndësisë, vlerës provuese dhe besueshmërisë.<sup>59</sup> Gjithashtu, kjo përputhet me vëzhgimet e monitorimit të gjykimeve nga OSBE-ja, të cilat kanë identifikuar në mënyrë të përsëritur sfida që lidhen me qasjen në prova, zbulimin e tyre në kohë dhe vlerësimin gjyqësor të besueshmërisë dhe peshës së tyre në procedurat e krimeve të luftës.

OSBE-ja ka identifikuar fusha sfiduese në lidhje me provat e paraqitura gjatë gjykimeve të krimeve të luftës, siç tregohet më hollësisht më poshtë.

### **i. Besueshmëria dhe vlera provuese e dëshmisë së dëshmitarit**

Rastet e krimeve të luftës të shqyrtuara nga Departamenti Special shpesh mbështeten kryesisht në dëshmitë e dëshmitarëve, pasi nga koha e ngjarjeve janë në dispozicion vetëm prova të kufizuara mjeko-ligjore bashkëkohore. Prandaj, pesha që trupi gjykues i jep dëshmisë në procesin e vlerësimit është veçanërisht e theksuar. Në rastet kur paraqiten mospërputhje ose ndryshime në dëshmi, gjykata duhet të shqyrtojë me kujdes besueshmërinë dhe kredibilitetin e fakteve dhe identifikimeve të dhëna nga dëshmitarët,<sup>60</sup> duke marrë parasysh kalimin e kohës, rrethanat në të cilat janë dhënë deklaratat e mëparshme, si dhe çdo faktor tjetër kontekstual përkatës.

OSBE-ja ka vëzhguar disa raste në të cilat dëshmitarët që kishin dhënë më parë deklarata kishin ndryshuar aspekte të dëshmisë së tyre pasi ishin paraqitur në bankën e dëshmitarit.<sup>61</sup>

Për shembull, në një rast, avokati mbrojtës e kundërshtoi dëshminë e dëshmitarit i cili, gjatë seancës dëgjimore, deklaroi se veprat penale mund t'i atribuoheshin të pandehurit duke e vendosur të pandehurin në vendin e ngjarjes. Megjithatë, në deklaratat e mëparshme, dëshmitari nuk e kishte identifikuar kryerësin e veprave dhe nuk e kishte përmendur kurrë të akuzuarin me emër.

<sup>58</sup> *Strategjia e Krimeve të Luftës*, f. 11–12

<sup>59</sup> Ndër të tjera, *shih* nenin 14 të PNDKP-së, nenin 6 të KEDNJ-së; TPNJ, *Kupreškić et al.*, Dhoma e Apelit, Aktgjykimi i 23 tetorit 2001, par. 39.

<sup>60</sup> Siç është përsëritur nga Departamenti i Posaçëm i Gjykatës së Apelit, në vendimin e tij të datës 30 shtator 2024.

<sup>61</sup> Meqë OSBE-ja nuk i ka faktet për vlerësimin e këtij fakti, ajo e mbështet këtë vëzhgim vetëm në komentet e palëve të bëra gjatë seancës dëgjimore.

Siç është vënë në pah nga Gjykata e Apelit, vlera provuese e provave duhet të analizohet në hollësi dhe duhet të merren në konsideratë kontradiktat, paqartësitë dhe mospërputhjet.<sup>62</sup> Kalimi i kohës mund të ndikojë gjithashtu në besueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve, fakt ky që shpesh përmendet nga dëshmitarët gjatë dëshmisë së tyre.

Në fakt, në një rast, dëshmitari shpjegoi se kishte vështirësi në identifikimin e të akuzuarit si personin përgjegjës për veprimet, sepse kishin kaluar shumë vite dhe i pandehuri kishte pësuar ndryshime fizike. Në të njëjtin rast, dëshmitari tjetër identifikoi individët që ishin rrahur nga i pandehuri, por emrat e viktimave ndryshonin nga ato që kishte përmendur më parë. Kur u pyet për këtë mospërputhje, dëshmitari ia atribuoi atë kalimit të kohës.

Ka pasur raste në të cilat Gjykata e Apelit e ka kthyer rastin në gjykatën themelore për rigjykim në bazë të kontradiktave të konsiderueshme në dëshmitë e dëshmitarëve dhe palëve të dëmtuara.<sup>63</sup> Derisa OSBE-ja e vlerëson peshën që Gjykata e Apelit ia ka dhënë nevojës për dëshmi të besueshme dhe kredibile, është e rëndësishme të kujtojmë se rigjykimet shkaktojnë vonesa dhe kërkojnë burime të konsiderueshme shtesë. Prandaj, OSBE-ja konsideron se vlerësimi i besueshmërisë dhe kredibilitetit të provave të ofruara nga dëshmitarët duhet të trajtohet plotësisht në nivel të shkallës së parë. Për më tepër, prokuroria duhet të sigurohet që dëshmitarët e thirrur për të dëshmuar janë relevantë dhe të besueshëm përpara se të mbështetet tek ata në aktakuzë dhe kur kërkon paraburgim.

## **ii. Dëshmia e drejtpërdrejtë, deklaratat e regjistruara më parë dhe kufizimet në sigurimin e provave nga jashtë Kosovës**

Përdorimi i deklaratave të dëshmitarëve të regjistruara paraprakisht lejohet sipas neneve 119 dhe 256 të KPP-së dhe mund të arsyetohet në rrethana specifike dhe të kufizuara. Megjithatë, OSBE-ja ka vërejtur preferencë të përsëritur për deklaratat e regjistruara më parë në krahasim me dëshmitë e drejtpërdrejta, veçanërisht kur dëshmitarët banojnë jashtë Kosovës. Kjo ngre shqetësime në procedurat e krimeve të luftës, ku dëshmia e dëshmitarëve shpesh luan rol qendror në vërtetimin e fakteve, veçanërisht kur ka mungesë ose disponueshmëri të kufizuar të provave dokumentare. Dëshmia e drejtpërdrejtë duhet të mbetet forma e preferuar e provës sa herë që është e mundur, pasi i mundëson gjykatës të vlerësojë menjëherë besueshmërinë dhe kredibilitetin e dëshmitarëve.

OSBE-ja ka vërejtur se deklaratat e mëparshme, mbi të cilat janë mbështetur rrethanat e tilla, shpesh janë regjistruar nga autoritete jashtë kontrollit institucional

---

<sup>62</sup> Vendimet e Gjykatës së Apelit: aps.nr.45/2024, 2022:113806, e 29 nëntorit 2024 (f. 6-10) dhe aps.nr.27/24, 2021:276857, e 4 nëntorit 2024 (f. 9-19).

<sup>63</sup> Po aty.

të Departamentit Special dhe në kushte që, në disa raste, kanë qenë të dokumentuara në mënyrë të pamjaftueshme ose të panjohura për gjyqtarët e trupit gjykues. Disa dëshmitarë që kishin dhënë deklarata të regjistruara më parë i kanë modifikuar ose sqaruar rrëfimet e tyre gjatë dëshmisë në gjykatë, duke nënvizuar rëndësinë që dëshmia e drejtpërdrejtë e ka në vlerësimin e besueshmërisë.

Në një rast, dëshmitari i ka shpjeguar mospërputhjet midis dëshmisë së tij në gjykatë dhe deklaratës së dhënë në vitin 2005 duke vënë në dukje se nuk kishte qenë i pranishëm asnjë përkthyes profesional dhe se fëmijët e tij kishin ndihmuar me përkthimin. Pas sqarimeve nga kryetari i trupit gjykues, dëshmitari e konfirmoi se dëshmia e tij para gjykatës pasqyrore rrëfimin e saktë të ngjarjeve.

Këto shqetësime rëndohen kur dëshmitarët dhe materiali provues ndodhen jashtë Kosovës<sup>64</sup> dhe bashkëpunimi funksional rajonal është shumë i kufizuar.<sup>65</sup> Derisa kufizimet e tilla ndikojnë në punën e prokurorisë, ato kanë po aq ndikim të menjëhershëm edhe për mbrojtjen, aftësia e së cilës për të paraqitur një rast efektiv mund të varet nga qasja në dëshmitarë dhe prova dokumentare që ndodhen jashtë Kosovës. Avokatët mbrojtës kanë ngritur vazhdimisht shqetësime se dëshmitarët nuk janë të gatshëm ose nuk janë në gjendje të udhëtojnë për në Prishtinë për shkak të shqetësimeve të sigurisë, dhe se mjetet alternative të dëshmisë, siç është video-lidhja, nuk janë gjithmonë në dispozicion në praktikë në mungesë të ndihmës juridike rajonale funksionale. Këto pengesa prekin drejtpërdrejt parimin e barazisë së palëve në procedurë dhe të drejtën e të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët sipas standardeve ndërkombëtare të gjyqimit të drejtë. Përderisa adresimi i këtyre çështjeve të bashkëpunimit kërkon në fund të fundit angazhim politik dhe diplomatik, OSBE-ja inkurajon kërkimin rrugëve ligjore dhe praktike për të rritur bashkëpunimin rajonal në çështjet me prioritet të lartë, për të siguruar që si prokuroria ashtu edhe mbrojtja të jenë në gjendje të paraqesin në mënyrë efektive rastet e tyre dhe që procedurat të jenë në përputhje me garancitë ndërkombëtare për gjykim të drejtë.

Në të njëjtën kohë, monitorimi i OSBE-së tregon se problemi nuk është vetëm te bashkëpunimi, por edhe te mbrojtja dhe besimi i dëshmitarëve. Korniza ligjore në Kosovë parasheh garanci për mbrojtjen e dëshmitarëve, duke përfshirë edhe ato sipas *Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve* dhe dispozitave përkatëse të KPP-së.<sup>66</sup> Megjithatë, mbeten sfida praktike për të siguruar që këto garanci të perceptohen si të mjaftueshme nga dëshmitarët në procedurat e ndjeshme të krimeve të luftës. OSBE-ja ka vërejtur se disa dëshmitarë kanë shprehur ngurrim për të dëshmuar për

<sup>64</sup> Komisioni Evropian - Raporti i vitit 2024 për Kosovën, f. 29

<sup>65</sup> EULEX, (2024) Raporti i monitorimit të drejtësisë, f. 43, i disponueshëm në:

[https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/\(01.08.2025\)eu-rule-of-law-mission-justice-monitoring-report-2024.pdf](https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/(01.08.2025)eu-rule-of-law-mission-justice-monitoring-report-2024.pdf) [i hapur më 12 qershor 2026]

<sup>66</sup> Gazeta Zyrtare (1 shtator 2011) Ligji nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2758> [qasur më 12 qershor 2026] siç referohet në nenin 223 të KPP-së, përveç mbrojtjes së ofruar në Kapitullin XIII të KPP-së.

shkak të frikës nga kontrolli i shtuar dhe shqetësimeve që lidhen me sigurinë. Në disa raste, Departamenti Special është përgjigjur duke mbajtur seanca dëgjimore me dyer të mbyllura, duke treguar vetëdijesim për këto shqetësime; megjithatë, vazhdimësia e një frike të tillë mbetet e rëndësishme kur vlerësohen si disponueshmëria e dëshmitarëve ashtu edhe mundësia e sigurimit të dëshmisë së drejtpërdrejtë.

Monitorimi i gjykimeve nga OSBE-ja tregon më tej se si gjykatat ashtu edhe palët mbeten të kufizuara në aftësinë e tyre për t'i adresuar këto vështirësi në praktikë. Në një rast, dy dëshmitarë të prokurorisë që banonin jashtë Kosovës u konsideruan të padisponueshëm për të dëshmuar, ndërsa prokuroria propozoi që deklaratat e tyre të mëparshme gjatë hetimit të shënoheshin në procesverbal për të shmangur zgjatjen e procedurave. Pavarësisht kundërshtimit të mbrojtjes, gjykata i pranoi deklaratat dhe i përfshiu ato në procesverbalin e seancës dëgjimore. Në një rast tjetër, avokati mbrojtës e informoi gjykatën se shumica e dëshmitarëve të propozuar jetonin jashtë Kosovës dhe nuk ishin të gatshëm të paraqiteshin personalisht, duke propozuar në vend të kësaj dëshminë përmes videolidhjes ose, si alternativë, dorëzimin e deklaratave të noterizuara të marra në vendin ku ata banojnë. Gjykata tregoi se dëshmia me videolidhje do të kërkonte iniciimin përmes kanaleve zyrtare brenda Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa si prokuroria ashtu edhe gjykata hodhën poshtë përdorimin e deklaratave të noterizuara me arsyetimin se ato janë të papajtueshme me Kodin e Procedurës Penale.

Sipas nenit 6(1) dhe nenit 6(3)(d) të KEDNJ-së, i akuzuari ka të drejtë për proces të rregullt dhe, në veçanti, për të marrë në pyetje ose për të kërkuar marrjen në pyetje të dëshmitarëve. GJEDNJ-ja ka mbajtur vazhdimisht qëndrimin se dënimet nuk duhet të bazohen vetëm ose në masë vendimtare në deklaratat e dëshmitarëve të cilët mbrojtja nuk ka pasur mundësi t'i marrë në pyetje, dhe se duhet të ketë masa të përshtatshme kundërbalancuese kur pranohen prova të tilla.<sup>67</sup> Gjykatat, sa herë që është e mundur, duhet t'i japin përparësi dëshmimeve të drejtpërdrejta dhe të përdorin më plotësisht masat alternative në dispozicion, duke përfshirë dëshminë me videolidhje kur është e përshtatshme, për të siguruar që dëshmitarët të mund të merren në pyetje dhe të kundërshtohen në mënyrë efektive përmes marrjes në pyetje të tërthortë, në përputhje me të drejtat e mbrojtjes dhe drejtësinë e përgjithshme të procedurave. Derisa OSBE-ja e ka të qartë që disa dëshmitarë mund të mos jenë më të disponueshëm për të dëshmuar dhe se mund të ketë kufizime praktike, gjykatat duhet t'i vlerësojnë me kujdes të veçantë kërkesat për të zëvendësuar provat e drejtpërdrejta me deklarata të regjistruara më parë, sidomos kur mbrojtja nuk ka pasur mundësi paraprake për t'i kundërshtuar ato prova dhe kur rrethanat në të cilat janë marrë deklaratat janë të paqarta ose të dokumentuara në mënyrë të pamjaftueshme.

---

<sup>67</sup> GJEDNJ, *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar* (GC), nr. 26766/05 dhe 22228/06, Aktgjykimi i datës 15 dhjetor 2011, paragrafët 106, 147.

OSBE-ja ka vënë re raste të praktikës së mirë. Në raste të caktuara, Paneli ka refuzuar të pranojë dëshmi të regjistruara më parë me arsyetimin se nuk ishin siguruar garanci procedurale të kërkuara në kohën kur janë marrë deklaratat.

Për shembull, në një rast, prokuroria propozoi që tre dëshmitarë të mos merreshin në pyetje në gjykatë dhe që deklaratat e tyre të mëparshme të lexoheshin në procesverbal. Paneli e hodhi poshtë këtë propozim, duke vënë në dukje se dëshmitarët ishin marrë në pyetje në mungesë të avokatit mbrojtës, duke mos përmbushur kështu standardet minimale të kërkuara për të siguruar pranueshmërinë dhe drejtësinë e provave të tilla.

## **E. Çështje specifike për gjykimet në mungesë**

### **i. Standardet ligjore për gjykimet në mungesë**

#### **Standardet ndërkombëtare**

Prania fizike e të akuzuarit si komponent thelbësor i së drejtës për një proces të rregullt është paraparë në PNDCP.<sup>68</sup> Megjithatë, zhvillimi i gjykimeve *në mungesë* mund të jetë i lejueshëm në rrethana të jashtëzakonshme, me kusht që të respektohen garancitë e duhura procedurale për të siguruar baraspeshë të duhur midis të drejtave të të akuzuarit dhe interesave të drejtësisë. Ky parim është pohuar vazhdimisht nga GJEDNJ-ja sipas nenit 6 të KEDNJ-së.<sup>69</sup> GJEDNJ-ja ka njohur se gjykimet në mungesë nuk janë, si të tilla, të papajtueshme me Konventën dhe mund t'i shërbejnë interesit legjitim të sigurimit të administrimit efektiv të drejtësisë dhe parandalimit të pandëshkueshmërisë, me kusht që i akuzuari të jetë informuar mirëfilli për procedurat dhe të ushtrojë të drejtën për mjete juridike efektive, përfshirë rigjykimin.<sup>70</sup>

Ky parim u përsërit më tej nga Këshilli i Evropës në opinionin e tij lidhur me zhvillimin e gjykimeve në mungesë në Kosovë.<sup>71</sup>

#### **Standardet vendore**

Struktura aktuale e nenit 303 të KPP-së i është nënshtruar një procesi të gjatë ndryshimi dhe rishikimi, duke kulmuar në formën e saj aktuale. Çështja e rolit dhe

---

<sup>68</sup> Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (16 dhjetor 1966), neni 14. Gjetet tek:

<https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights> [qasur më 12 qershor 2026]

<sup>69</sup> Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut) (19 qershor 2020), "Opinion mbi disa dispozita të projekt-kodit të procedurës penale, përkatësisht gjykimin në mungesë (neni 306) dhe pezullimin e zyrtarëve nga detyra (neni 177)", Opinioni Nr. 985 / 2020, f. 5.

<sup>70</sup> *Colozza kundër Italisë*, kërkesa nr. 9024/80, vendim i datës 12 shkurt 1985; *Sejdovic kundër Italisë* [GC], kërkesa nr. 56581/00, vendim i datës 1 mars 2006; *Medenica kundër Zvicrës*, kërkesa nr. 20491/92, vendim i datës 14 qershor 2001. *Shih* edhe *Hermi kundër Italisë* [GC], nr. 18114/02, aktgjykim i datës 18 tetor 2006.

<sup>71</sup> Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venedikut), f. 5.

legjitimitetit përkatës të gjykimeve në mungesë në Kosovë ka qenë objekt debati prej kohësh. Për të kuptuar më mirë garancitë ekzistuese dhe çështjet e pazgjidhura lidhur me nenin aktual 303, është e dobishme të gjurmojmë shkurtimisht fazat kryesore që çuan në aktakuzën e parë të ngritur në mungesë më 2 maj 2023.

Në korrik të vitit 2019, hynë në fuqi ndryshim/plotësimet në Kodin e Procedurës Penale të atëhershëm, duke lejuar gjykimin në mungesë për vepra penale kundër së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe krime të tjera të rënda të kryera midis janarit 1990 dhe qershorit 1999.<sup>72</sup> Megjithatë, kriteret procedurale të vëna në funksion me këto ndryshime ishin të gjata dhe të ndërlikuara, duke e bërë praktikisht të pamundur zbatimin praktik të gjykimeve në mungesë. Ndryshim/plotësimi i dytë, që hyri në fuqi nga qershori 2021, thjeshtoi më tej kriteret procedurale që rregullojnë gjykimet e tilla. Më pas, në gusht të vitit 2022, u miratua Kodi i ri i Procedurës Penale<sup>73</sup>, duke sjellë edhe nenin 303, që zgjeron dispozitën për gjykimet në mungesë në kategori të mëtejshme të veprave penale. Një aspekt tjetër i garancive procedurale të parapara me nenin 303 është e drejta për rigjykim me kërkesë të të pandehurit, pasi ai të jetë gjetur. Aktualisht, nuk është gjetur asnjë person që është gjykuar në mungesë, dhe për këtë arsye, kjo masë mbrojtëse nuk është shfrytëzuar ende.

## ii. Paqartësia në lidhje me "përpyjekjet e arsyeshme" për njoftimin e të akuzuarit

Me KPP-në aktual, para se aktakuza të parashtrohet në mungesë, ka hapa specifikë proceduralë që duhen ndërmarrë për të siguruar që gjyqtari i vetëm apo trupi gjykues të jetë bindur që *"përpyjekje të arsyeshme janë bërë për të njoftuar të akuzuarin për gjykimin, si dhe për të siguruar praninë e të akuzuarit."*<sup>74</sup> Këto përpyjekje përfshijnë:

- Lëshimi i thirrjes gjyqësore;
- Lëshimi i urdhrit;
- Verifikimi i adresës së të pandehurit; dhe
- Lëshimi i urdhër-arrestit.

Për të ilustruar hapat e detajuar të ndërmarrë nga prokuroria, njëri rast ofron shembullin në të cilin urdhër-arresti u nxor më 8 shkurt 2018:<sup>75</sup>

- Më 27 mars 2018, prokuroria u njoftua se urdhër-arresti nuk mund të ekzekutohej pasi i pandehuri nuk jetonte në adresën e fundit të regjistruar. Dy ditë më vonë, u lëshua urdhër-arresti për gjithë Kosovën;

<sup>72</sup> Gazeta Zyrtare (23 nëntor 2023) Ligji nr. 06/L-091 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale nr. 04/L-123. Gjetet tek: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20500&langid=2> [qasur më 12 qershor 2026]

<sup>73</sup> Po aty.

<sup>74</sup> Po aty, neni 303(7)

<sup>75</sup> Ky informacion vjen nga aktakuza e ngritur nga Prokuroria Speciale në vitin 2023.

- Rreth dy muaj më vonë, prokuroria kërkoi urdhër kërkimi ndërkombëtar dhe 15 ditë më vonë, gjykata nxori urdhrin, që iu dërgua Ministrisë së Drejtësisë;
- Më 6 qershor 2018 (10 ditë më vonë - dhe rreth gjashtë muaj pas fillimit të hetimit), prokuroria pezulloi hetimin për shkak të mospranisë së të pandehurit;
- Më 17 maj 2022 (gati katër vjet pas pezullimit të hetimit), prokuroria vendosi të rihapë hetimin pas ndryshimeve të propozuara në ligj që sollën nenin 303 të KPP-së në lidhje me gjykimin në mungesë;<sup>76</sup>
- Më 19 maj 2022, prokuroria u dërgoi autoriteteve të Beogradit thirrje për intervistë që duhej t'i dorëzohej të pandehurit, pasi u vërtetua se aty ishte vendbanimi i fundit i të pandehurit. Prokuroria nuk mori asnjë përgjigje dhe i pandehuri nuk u paraqit ditën e caktuar për intervistim;
- Më 20 shtator 2022, prokuroria kërkoi - dhe Gjykata miratoi - urdhër për ta shpallur të pandehurin në kërkim për hetim për periudhë gjashtëmujore në Gazetën Zyrtare dhe më pas në media;
- Më 2 tetor 2023 (rreth një vit më vonë), PS-ja ngriti aktakuzën në mungesë ndaj të pandehurit;
- Më 21 shkurt 2024, seanca fillestare dëgjimore u mbajt në mungesë. Që atëherë nuk është zhvilluar asnjë seancë tjetër.

Ky shembull ilustron shumëllojshmërinë e hapave proceduralë që kërkohen nga institucionet e ndryshme të përfshira, duke nënvizuar nevojën për koordinim dhe bashkëpunim të shtuar midis PS-së, Departamentit Special, Ministrisë së Drejtësisë, policisë dhe medias. Përveç kësaj, sfidat që lidhen me bashkëpunimin rajonal mund të kontribuojnë më tej në vonesa dhe pasiguri në zhvillimin e procedurave.

Derisa PS-ja ka ngritur 20 aktakuza në mungesë që nga maji i vitit 2023, vetëm shtatë prej tyre kanë çuar në mbajtjen e seancës fillestare dhe vetëm tre gjykime kanë përfunduar. Prandaj, ka të dhëna të kufizuara në dispozicion në lidhje me pritjet e Departamentit Special mbi arsyeshmërinë e përpjekjeve.

Shtrirja dhe interpretimi i asaj që përbën "përpjekje të arsyeshme" mbeten në thelb të sfidave ligjore dhe praktike që lidhen me gjykimet në mungesë. Koncepti i "përpjekjeve të arsyeshme" përfshin dy kritere paralele: së pari, veprimet procedurale që duhet të ndërmerren dhe së dyti, afatin kohor të veprimeve procedurale. Ndërkohë që kriteret e veprimeve procedurale janë sqaruar me nenin 303 (7) të KPP-së, ka nevojë për më shumë qartësi në lidhje me afatin kohor brenda të cilit duhet të lëshohen thirrjet dhe urdhrat, ose përmasat e komunikimit publik që nevojitet për të informuar të akuzuarit dhe për t'i bërë thirrje që të dorëzohen në gjykatë.

<sup>76</sup> Gazeta Zyrtare (17 gusht 2022) Kodi Nr. 08/L -032 i Procedurës Penale.

Vlen të përmendet se Gjykata e Apelit, nëpërmjet një vendimi,<sup>77</sup> i dha Gjykatës Themelore udhëzime më të hollësishme mbi atë që përbën "përpjekje të arsyeshme" për informimin e të pandehurit në mungesë, duke përfshirë hapat specifikë proceduralë për të siguruar njoftimin e duhur dhe për të garantuar të drejtat e mbrojtjes.<sup>78</sup> Ky zhvillim është hap pozitiv drejt sqarimit të standardit të "përpjekjeve të arsyeshme".

Megjithatë, OSBE-ja thekson veçanërisht se kërkohen sqarime të mëtejshme në lidhje me zbatimin konkret të standardit të "përpjekjeve të arsyeshme" duke marrë parasysh numrin në rritje të aktakuzave në mungesë që mbeten në fazën paraprake të gjyqimit. Në këtë drejtim, nxjerrja e udhëzimeve të mëtejshme të hollësishme – përcaktimi i afateve kohore dhe specifikimi i hapave proceduralë – do të kishte rol kyç në adresimin e këtyre sfidave, duke rritur kështu sigurinë juridike dhe duke u mundësuar palëve të ecin përpara me procedurat në mungesë në mënyrë më efektive.

### iii. Vonesat dhe rezultatet e gjykimeve të mbajtura në mungesë

Siç është theksuar më parë, që kur neni 303 ka hyrë në fuqi, PSRK-ja ka ngritur 20 aktakuza në mungesë, megjithatë, 85 për qind e këtyre aktakuzave kanë mbetur në fazën paraprake të gjyqimit dhe vetëm 15 për qind kanë shkuar deri në aktgjykim të plotfuqishëm (*shih* grafikun më poshtë). Vlen të përmendet se të gjitha rastet që kanë shkuar në gjykim dhe për të cilat është nxjerrë vendimi gjyqësor, kanë rezultuar me aktgjykim dënues me dënime prej 15 vitesh, dënimi më i lartë i mundshëm për rastet e krimeve të luftës në Kosovë.




<sup>77</sup> Vendimi u bë publik më 27 shkurt 2026.

<sup>78</sup> Sipas nenit 303(8) të KPP-së, përpjekjet e arsyeshme përfshijnë procedurat e njoftimit sipas neneve 172 dhe 173 të KPP-së, fushatë të plotë informuese që u bënë thirrje të akuzuarve të dorëzohen dhe publikimin e thirrjes dhe aktakuzës në faqet e internetit të Prokurorit të Shtetit dhe gjykatës kompetente, si dhe në Gazetën Zyrtare. Përveç këtyre, në aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit theksoi që gjykimi në mungesë mund të vazhdojë vetëm nëse gjykata ka ndërmarrë përpjekje të arsyeshme për të siguruar praninë e të pandehurit, i pandehuri është njoftuar efektivisht për procedurën, ka prova të qarta që i pandehuri po i shmanget drejtësisë, si dhe të drejtat e mbrojtjes janë respektuar plotësisht.

Vonesat e vërejtura midis ngritjes së aktakuzës dhe mbajtjes së seancës fillestare duken të konsiderueshme. Sipas KPP-së, kur i akuzuari nuk është në paraburgim, seanca fillestare duhet të zhvillohet brenda 30 ditëve nga ngritja e aktakuzës.<sup>79</sup> Në rastet në mungesë që kanë shkuar në gjykim, koha mesatare e kaluar midis ngritjes së aktakuzës dhe seancës fillestare është 223 ditë, duke e tejkaluar afatin maksimal kohor të përcaktuar nga KPP-ja me më shumë se shtatë herë.

Situata duket edhe më shqetësuese në rastet e procedurës paraprake në mungesë. Në rastet kur është ngritur aktakuza dhe është mbajtur seanca fillestare, koha e kaluar arrin mesatarisht në 300 ditë. Në rastet kur është ngritur aktakuza mes viteve 2023 dhe 2025, por ende nuk është mbajtur seanca fillestare, analiza tregon se kanë kaluar mesatarisht 395 ditë midis ngritjes së aktakuzës dhe datës referente të këtij raporti (31 dhjetor 2025), gjë që tregon se këto raste vazhdojnë të presin pa u caktuar seanca fillestare.<sup>80</sup> Grafiku më poshtë<sup>81</sup> ilustron këto vonesa të zgjatura në krahasim me kriterin e KPP-së për të mbajtur seancën fillestare dëgjimore brenda 30 ditëve nga ngritja e aktakuzës (vija e kuqe).



Ndërsa OSBE-ja vëren se prioritet kanë rastet që përfshijnë persona të akuzuar në paraburgim, ajo vëren se, në procedurat në mungesë, shqyrtimi në kohë i të drejtave të viktimave, e sidomos e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u marrë parasysh situata e tyre, mbetet element i rëndësishëm i procedurës. Vonesat në fazën fillestare mund të ngrenë shqetësime në lidhje me administrimin e mirëfilltë të drejtësisë dhe mund të ndikojnë te viktimat dhe në perceptimin e publikut për drejtësinë e procesit. Në këtë kontekst, OSBE-ja inkurajon mbajtjen e seancave fillestare dëgjimore brenda afateve kohore të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale për të gjitha rastet penale.

<sup>79</sup> Gazeta Zyrtare (17 gusht 2022) Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 236 (4) dhe (5)

<sup>80</sup> Kjo mesatare bazohet në 13 raste në mungesë, ku aktakuzat janë ngritur midis majit 2023 dhe 31 dhjetorit 2025 në të cilat nuk është mbajtur seanca fillestare dëgjimore.

<sup>81</sup> Grafiku më poshtë bazohet në rastet në mungesë, për të cilat OSBE-ja ka arritur të mësojë edhe datën e ngritjes së aktakuzës edhe datën e seancës fillestare dëgjimore.

#### **iv. Mbrojtja e të drejtave të viktimave**

Një nga qëllimet e gjykimit në mungesë është që të sjellë drejtësi për viktimat dhe të mundësojë kompensimin. Është theksuar po ashtu si mjet i drejtësisë tranzicionale, që nxit pajtimin dhe siguron llogaridhënie si mjet për luftim të pandëshkueshmërisë.<sup>82</sup> Sipas Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit,<sup>83</sup> viktimat mund të aplikojnë për kompensim edhe në rastet kur autori i krimit është i paarritshëm nga autoritetet e zbatimit të ligjit.<sup>84</sup>

Sipas Nenit 10 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, viktimat ose anëtarët e familjes së saj mund të paraqesin kërkesë për kompensim në emër të viktimës, duke përfshirë kërkesat për vuajtje psikologjike që vijnë nga humbja e një anëtari të familjes, humbja e të drejtës për mbështetje financiare dhe shpenzimet e varrimit.<sup>85</sup> Kërkesa duhet të paraqitet brenda tre viteve nga pranimi i vendimit të plotfuqishëm dhe marrja e njoftimit për ekzistimin e rrethanave të përmendura në nenin 9, përkatësisht që autori i krimit është i paqashtëm për autoritetet ligjzbatuese.<sup>86</sup>

OSBE-ja mbështet qasjen në kompensim për viktimat e krimeve të luftës, duke përfshirë viktimat që fitojnë të drejtën përmes procedurave gjyqësore në mungesë. Megjithatë, kur merren parasysh vonesat e konsiderueshme në nxjerrjen e vendimeve të plotfuqishme dhe numrin e kufizuar të rasteve në mungesë që kanë rezultuar me vendime të tilla, OSBE-ja shpreh shqetësimin se, në praktikë, ky komponent i rëndësishëm i procedurave në mungesë nuk është efektivisht i qashtëm për viktimat e krimeve të luftës. Prandaj, OSBE-ja inkurajon zvogëlimin e vonesave në procedurat në mungesë dhe sigurimin që aktakuzat e ngritura në mungesë të çojnë në aktgjykime të plotfuqishme.

#### **v. E drejta për mbrojtje të përshtatshme**

Një nga risitë e nenit 303(7) në krahasim me ndryshimet e mëparshme që lejonin gjykimet në mungesë – është përmendja e qartë e mbrojtjes së detyrueshme sipas neneve 11 dhe 56 të KPK-së, të zbatuara përshtatshëm. Sipas këtyre dispozitave, i pandehuri në mungesë duhet të përfaqësohet nga avokati mbrojtës i caktuar nga gjykata. Kjo e drejtë mbrohet më tej nga neni 6(3) i KEDNJ-së, që përmend të drejtën e secilit person të akuzuar për vepër penale për t'u mbrojtur në mënyrë efektive nga avokati, si tipar themelor i gjykimit të drejtë.<sup>87</sup> Një gjë pozitive është që monitoruesit

---

<sup>82</sup> Raporti i IBA-s (2016) mbi Tryezën e Rrumbullakët të 'Ekspertëve' mbi gjykimet në mungesë në drejtësinë penale ndërkombëtare, f. 2., gjendet tek: <https://www.ibanet.org/document?id=Experts-roundtable-trials-in-absentia> [qasur më 12 qershor 2026]

<sup>83</sup> Gazeta Zyrtare (2 nëntor 2022) Ligji nr. 08/L-109 për Kompensimin e viktimave të krimit. Gjendet tek: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66178> [qasur më 12 shtator 2026]

<sup>84</sup> Gazeta Zyrtare (Nëntor 2022) Ligji për Kompensimin e viktimave të krimit, neni 9, pika 5.1.4. Gjendet tek: <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=66178> [qasur më 12 shtator 2026]

<sup>85</sup> Po aty, neni 10.

<sup>86</sup> Po aty, neni 29(2).

<sup>87</sup> Neni 6(3)c i KEDNJ-së; shih *Neziraj kundër Gjermanisë*, Kërkesa nr. 30804/07, (2012), paragrafi 50; *Van Geyseghe kundër Belgjikës* [GC], nr. 26103/95.

e OSBE-së kanë raportuar se të gjithë të akuzuarve që gjykohen në mungesë u është caktuar avokati mbrojtës për t'i përfaqësuar në procedurat gjyqësore.

Megjithatë, ndonëse kjo dispozitë mbron shprehimisht të akuzuarin, fushëveprimi i saktë i asaj që përbën "mbrojtje adekuate" në kuadër të mbrojtjes së detyrueshme sipas nenit 56 të KPP-së mbetet pamjaftueshëm i përkufizuar. Kur i pandehuri nuk emëron avokat mbrojtës, caktohet avokati mbrojtës i pavarur dhe, sipas nenit 11(3) të KPP-së, avokati i tillë duhet të ketë "përvojën dhe kompetencën në përputhje me llojin e veprës."<sup>88</sup> Në kontekstin e procedurave për krime lufte, ky kriter nënkupton që avokati i emëruar duhet të ketë përvojë me raste me kompleksitet të krahasueshëm. Për më tepër, marrë parasysh veçantitë dhe pasojat procedurale të gjykimeve në mungesë, është qenësore që ekspertiza e atij mbrojtësi të përfshijë edhe mbrojtjen e personave të akuzuar të gjykuar në mungesë.

OSBE-ja vëren se, në praktikë, Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK) emëron avokatë sipas rregullit të rrotacionit ose rendor, që synon të ndajë caktimet në mënyrë të drejtë midis avokatëve të regjistruar.<sup>89</sup> Për më tepër, duke pasur parasysh risinë e gjykimeve në mungesë dhe numrin relativisht të kufizuar të rasteve të krimeve të luftës që kanë arritur deri tek gjykimi, ka pak avokatë mbrojtës aktualisht që posedojnë nivelin e përvojës dhe kompetencës së nevojshme për të përmbushur plotësisht kriteret e parapara me nenin 11 të KPP-së. OSBE-ja sugjeron që, për aq sa është e mundur, OAK-u të sigurojë caktimin e avokatëve mbrojtës me ekspertizën e nevojshme, si dhe sugjeron ofrimin e trajnimit praktik, që do të ofrohej si në gjuhën serbe ashtu edhe në atë shqipe, për t'i mundësuar avokatëve mbrojtës të zhvillojnë kompetencat e duhura për të garantuar që të pandehurit e gjykuar në mungesë të kenë qasje në mbrojtje të plotë dhe efektive.

Për më tepër, ndërveprimi midis neneve 11, 56 dhe 303 të KPP-së krijon paqartësi interpretimi për sa i përket të drejtës së avokatit mbrojtës të caktuar për të pandehurit e gjykuar në mungesë për të kërkuar mjete të jashtëzakonshme juridike<sup>90</sup>. Neni 56(1.5) i KPP-së ndërlidh shprehimisht kriterin e mbrojtjes së detyrueshme për gjykimet në mungesë me nenin 303 të KPP-së; megjithatë, referenca ndaj mjeteve të jashtëzakonshme juridike shfaqet vetëm në nenin 56(1.4), pa përmendur shprehimisht të pandehurit e gjykuar në mungesë.

Sipas intervistave dhe diskutimeve midis OSBE-së dhe akterëve të gjyqësorit, kjo ndërthurje krijon paqartësi nëse avokati mbrojtës mund të përdorë mjete juridike të jashtëzakonshme në emër të të pandehurit të gjykuar në mungesë, për shembull

---

<sup>88</sup> KPK, neni 11.

<sup>89</sup> Raporti i OSBE-së (2022) mbi të Drejtën e përfaqësimit efektiv në procedurat penale dhe sistemin e emërimeve në detyrë zyrtare, ff. 15-16. Gjetet tek: <https://omik.osce.org/sites/default/files/f/documents/8/0/523952.pdf> (accessed on 8 June 2026) [qasur më 12 qershor 2026]

<sup>90</sup> Neni 419 i KPP-së parashihet mjete të jashtëzakonshme juridike që mundësojnë që aktgjykimet e formës së prerë të kundërshtohen vetëm në rrethana të përcaktuara në mënyrë strikte dhe të jashtëzakonshme. Këto mjete juridike përfshijnë rihapjen e procedurave penale, zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe mbrojtjen e ligjshmërisë.

duke parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme, mjet juridik ky që përndryshe do të ishte në dispozicion për persona të tjerë të pandehur.<sup>91</sup>

Ka nevojë të sqarohet kjo çështje, duke përfshirë fushëveprimin dhe kufizimet e rolit të avokatit mbrojtës kur përfaqëson të pandehurit në mungesë. OSBE-ja inkurajon që të sigurohet që avokatët mbrojtës të caktuar për të pandehurin e gjykuar në mungesë të kenë qasje të plotë në të gjitha mjetet e jashtëzakonshme juridike.

## 5. Përfundime

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se gjykatat në Kosovë kanë bërë hapa të rëndësishëm në konsolidimin e rolit të tyre në gjykimin e krimeve të luftës. Megjithatë, sfida të konsiderueshme strukturore dhe procedurale vazhdojnë të ndikojnë në zhvillimin e procedurave para Departamentit Special të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Vonesat e tejzgjatura, vështirësitë e përsëritura që kanë të bëjnë me praninë e dëshmitarëve, zbulimin dhe përkthimin e provave, si dhe pasiguria në zbatimin e garancive procedurale, sidomos në gjykimet e zhvilluara në mungesë, kanë ndikim kumulativ në efikasitetin, konsistencën dhe drejtësinë e procedurave. Këto sfida rëndohen nga kufizimet e kapaciteteve brenda institucioneve prokuroriale dhe gjyqësore dhe nga bashkëpunimi i kufizuar rajonal, që vazhdon të ndikojë në qasjen në prova dhe dëshmitarë që ndodhen jashtë Kosovës.

Njëkohësisht, OSBE-ja ka njohur përpjekjet e ndërmarra nga akterët gjyqësore në zbatim të standardeve ndërkombëtare të gjyimit të drejtë në raste komplekse dhe të ndjeshme, si dhe nismat që janë ndërmarrë së fundmi që synojnë përforcimin e kornizës ligjore në fuqi përmes planifikimit strategjik dhe reformës legjislative.


Rekomandimet e dhëna në këtë raport kanë për qëllim të mbështesin këto përpjekje duke adresuar mangësitë e vazhdueshme të vërejtura përmes monitorimit të gjykimeve. Zbatimi i tyre efektiv do të kërkojë zotim të qëndrueshëm politik, burime të mjaftueshme, koordinim të përmirësuar institucional, si dhe angazhim të vazhdueshëm me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë. Adresimi i këtyre çështjeve mbetet qenësor për të siguruar llogaridhënie, për të mbrojtur të drejtat e të akuzuarve dhe viktimave, si dhe për të forcuar besimin e publikut në administrimin e drejtësisë.

---

<sup>91</sup> Intervistë me avokat mbrojtës më 25 nëntor 2025; Tryezë e rrumbullakët me gjyqtarë dhe prokurorë, më 5 nëntor 2025.

# Pasqyrë historike

**Tribunali penal ndërkombëtar  
për ish-Jugosllavinë (1993 - 2017)**









Organization for Security and  
Co-operation In Europe  
Mission in Kosovo